REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET
KRYETAR I K.K.T-së

Z. EDI RAMA

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

ZNJ. BELINDA BALLUKU

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Z. IZET SILAJ

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak

Nr. 51, Datë 04.12.2020

Kryetar i Bashkisë

ZNJ. MAILINDA QILIMI

PLANI I PËRGJITHSHËM KOMBËTAR I BASHKISË DELVINË

RREGULLORE VENDORE

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 4, Datë 28.12.2020

Sektori i Planifikimit të Territorit: Kastriot Musllimi

STUDIO KONSULENTE: Studio "DEA". Nr. Liç 4919/10

deastudio
Rr. "Desnimoria e Kombit, Kullat Binjake Kulli 1 Kat 3
info@dea-studio.com www.dea-studio.com

Bashkia Delvinë

Plani i Përgjithshëm Vendor

Rregullore Vendore

Përmbajtja

KREU I – Dispozita të përgjithshme 3

KREU II – Administrimi i rregullores dhe territori 8

Seksioni I - Ligjshmëria dhe administrimi 8

Seksioni II – Autoritetet e planifikimit dhe juridiksioni i planit 10

KREU III – Rregullat e përdorimit të tokës 11

Seksioni I – Sistemet, kategoritë bazë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës 11

Seksioni II – Aktivitetet dhe funksionet në përputhje me kategoritë e përdorimit të tokës 15

KREU IV – Rregullat për çdo njësi 24

Seksioni I – Rregullat kryesore për çdo sistem territorial 24

Seksioni II – Rregullat dhe kriteret për ndërtimin e objekteve për qëllime bujqësore 30

Seksioni III – Normat e planifikimit dhe zhvillimit në zonat e banimit 33

KREU V - Instrumentet për drejtimin e zhvillimit 41

KREU VI - Rregullat e sistemit rrugor, transportit dhe hapësirave publike 47

KREU VII - Rregullat e ruajtjes së mjedisit, peizazhit, burimeve natyrore, zonave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore 54

KREU VIII - Dispozita kalimtare dhe të fundit 62

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

KREU I – Dispozita të përgjithshme

Neni 1_Qëllimi

1. Qëllimi i Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) të territorit të Bashkisë Delvinë është të përcaktojë rregullat, normat, standardet dhe instrumentet e zbatueshme, si dhe të orientojë proçedurat, për përdorimin dhe zhvillimin ekzistues dhe të ardhshëm të tokës, të mundësojë zbatimin e planit, dhe të garantojë se propozimet për zhvillim të sektorit publik dhe privat janë të balancuara dhe përmbushin qëllimet dhe objektivat e planit territorial dhe strategjisë së zhvillimit.

Neni 2_Struktura

1. Dokumenti bazë i rregullores së PPV përmban, por pa u kufizuar vetëm në:
   a. qëllimin e Rregullores së PPV-së;
   b. përkufizimet e termave të përdorura në këtë rregullore;
   c. rregullat e përdorimit të tokës:
   d. rregullat për çdo zonë dhe njësi;
   e. rregullat e nënndarjes dhe bashkimit të parcelave;
   f. rregullat e sistemit rrugor dhe transportit;
   g. rregullat e ruajtjes së mjedisit, peizazhit, burimeve natyrore, zonave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore.

Neni 3_Përkufizime

1. Fjalët e përdorura në kohën e tashme do të përfshijnë dhe të ardhmen; fjalët e përdorura në numrin njëjës do të përfshijnë edhe shumësin, dhe ato në shumës do të përfshijnë edhe njëjësin.

2. **"Bashki"** ka kuptimin Bashkia Delvinë.

3. **"Bashkim parcele",** është akti i bashkimit ligjor të dy ose më shumë parcelave në një të vetme në përputhje me këtë rregullore.

4. **"Blloqe banimi",** volume ndërtesash shumëkateshe banimi me karakteristika të ngjashme. Janë të organizuara në dy lloje: a) struktura ndërtimi të lira të vendosura në linjë ose në bllok. b) tipe ndërtesash që ndajnë mure të përbashkëta me ndërtimet ngjitur në të dyja krahët.

5. **"Dendësim/Mbushje urbane e tokës"**, është proçesi i densifikimit të një njësie të sistemit urban pjesërisht të zhvilluar dhe kryesisht homogjene për nga kategoria e përdorimit të tokës, me struktura të të njëjtit karakter, funksion, përdorim, tregues të planifikimit, zhvillimit dhe ndërtimit me ato të pronave/strukturave me të cilat kufizohet.

6. **"DPZHT",** është Departamenti i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të Bashkisë.

7. **"Hapësira të hapura"**, janë hapësira të pandërtuara ndërmjet strukturave, sipas rastit rrugë për hyrje në strukturë ose hapësira me një mbulesë vegjetacioni, sheshe parkimi, vendqëndrime dhe hapësira të gjelbëra në funksion të strukturës së ndërtuar dhe pjesë e parcelës së ndërtueshme.

8. **"Kategoritë e kushtëzuara të përdorimit të tokës dhe të strukturave në të"**, për një njësi të caktuar, vlerësohen zhvillimet jo të ndaluara realizimi i të cilave lejohet përmes plotësimit të kushteve shtesë ose të reja në kërkesën përkatëse për zhvillim dhe në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje dhe të PPV-së.

9. **"Kategoritë e lejuara të përdorimit të tokës dhe strukturave në të"**, për një njësi të caktuar, vlerësohen kategoritë e zhvillimeve të lejuara në atë njësi sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje për kategoritë bazë dhe në përputhje me PPV-në.

10. **"KKT",** është Këshilli i Kombëtar i Territorit të Republikës së Shqipërisë.

11. **"Konservimi"**, është procesi i ruajtjes dhe i mbrojtjes së një territori ose ndërtimi të caktuar, në formën e tij ekzistuese origjinale. Është tërësia e veprimeve të ndërmarra nga Bashkia apo çdo person juridik ose fizik, të cilat synojnë ruajtjen e një përdorimi, strukture dhe territori uban, të veshur me vlera ekonomike, sociale, historike e kulturore dhe mjedisore në kohë, dhe të raporteve që ajo krijon me mjedisin natyror apo të ndërtuar që e rrethon, për të realizuar zhvillim të qëndrueshëm të burimeve natyrore, sipas përcaktimit të legjislacionit të posaçëm në fuqi.

12. **"Konsolidim"**, është procesi i zhvillimit të territorit, i cili ka për qëllim përmirësimin dhe forcimin e infrastrukturës dhe strukturës urbane ekzistuese duke nxitur ndërtimin brenda zonave të urbanizuara.

13. **"Kopje origjinale të hartave",** janë hartat e Planit të cilat janë të firmosura për efekt vendimi të miratimit të Planit ose ndryshimeve të tij në përputhje me bazën ligjore.

14. **"Ligji",** i referohet Ligjit nr.107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar.

15. "**Monument kulture**" është objekti ose ndërtimi me vlera historiko-kulturore, që mbrohet nga shteti. Në kuptim të këtij ligji, në bazë të intensitetit të ndërhyrjes në pasuritë kulturore, këto të fundit kategorizohen në: a) "Monument kulture i kategorisë I" është ndërtimi me vlera të spikatura dhe me rëndësi të veçantë për trashëgiminë kulturore, i cili ruhet në tërësinë e përbërësve të tij arkitektonikë dhteknikë. Kompozimi i vëllimeve, trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme e të brendshme, si dhe zgjidhja planimetrike e funksionale e këtyre monumenteve nuk mund të ndryshohen. b) "Monument kulture i kategorisë II" është ndërtimi me vlera të spikatura kryesisht për pamjen e tij të jashtme, i cili ruhet në vëllime dhe përbërje arkitektonike të këtyre pamjeve të jashtme.

16. **"Ndërtim i Lehtë i Përkohshëm",** është çdo lloj ndërtimi që është i çmontueshëm (që mund të paketohet pa dëmtuar materialet përbërëse) dhe i përjashtuar ndërtimi në themele me bazamente betoni të përhershme ose të ngjashme.

17. **"Nënndarje parcele",** është akti i ndarjes ligjore të një parcele në dy ose më shumë parcela më të vogla në përputhje me rregulloren, që po prezantohet.

18. **"Njësi administrative",** ka kuptimin: Delvinë, Vergo.

19. **"Njësi e vetëqeverisjes vendore",** jane bashkite dhe qarqet, të cilat realizojnë vetëqeverisjen vendore në Republikën e Shqipërisë, sipas Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015.

20. **"Njësi strukturore",** është sipërfaqja më e vogël e territorit e përkufizuar nga Plani i Përgjitshëm Vendor, e identifikuar dhe planifikuar me kushte të njëtrajtshme zhvillimi sipas përcaktimeve të kësaj rregullore.

21. **"PDV",** është Plan i Detajuar Vendor.

22. **"Parcelë",** është termi i përdorur në këtë rregullore zhvillimi që nënkupton të gjitha përkufizimet ligjore dhe teknike të konceptit pronë, e identifikuar me numër të parcelës dhe e regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

23. "**Pasuri kulturore materiale**" është tërësia e pasurive të luajtshme e të paluajtshme që, sipas përcaktimeve të neneve 50 dhe 51, të këtij ligji, kanë interes artistik, historik, arkeologjik, arkitektonik, urbanistik, etnografik, arkivistik, bibliofilik, si dhe objekte të tjera, të përcaktuara ose parashikuara nga ligji si bartës të pasurive të qytetërimeve.

24. **"Përdorim homogjen"**, është përdorimi që karakterizohet nga ekzistenca e strukturave që i shërbejnë të njëjtit funksion, nga funksion i njëjtë në të gjithë sipërfaqen e tokës ku evidentohet përdorimi, dhe nga aktivitete të përputhshme që i shërbejnë të njëjtit funksion.

25. **"Person/a",** përfshin individë, kompani, shoqata jofitimprurëse, agjensi qeveritare dhe për të gjithë subjektet juridike.

26. **"PPV",** përdoret në kuptimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Delvinë miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit të Republikës së Shqipërisë.

27. **"Punime të mirëmbajtjes së zakonshme"**, janë ndërhyrjet për riparimin apo zëvendësimin e rifiniturave ekzistuese të ndërtesave, si dhe ato që janë të nevojshme për të mbajtur në efiçencë impiantet teknologjike ekzistuese.

28. "**Restaurim**" është vlerësimi i thelbit origjinal të vlerave të pasurive kulturore nëpërmjet ndërhyrjeve për ndalimin e degradimeve të mëtejshme, nxjerrjen në pah të vlerave kulturore dhe transmetimin e tyre. Në rastin e vlerave të trashëgimisë

kulturore të paluajtshme, që gjenden në zona të deklaruara me rrezik sizmik, sipas ligjeve në fuqi, restaurimi përfshin edhe ndërhyrjet për përmirësim strukturor.

29. **"Rigjenerim/ripërtëritje"**, procesi i përmirësimit të kushteve ekonomike, fizike, sociale dhe mjedisore të një territori apo ndërtimi.

30. **"Rizhvillim"**, është procesi i zhvillimit dhe i rindërtimit të një zonë, e cila është e ndërtuar, por e degraduar dhe kryesisht me mungesa të funksioneve kryesore.

31. **"Rregullore",** përdoret në kuptimin e Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor të Territorit të Bashkisë Delvinë miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit të Republikës së Shqipërisë.

32. **"Shtëpi të shkëputura, vila",** tipe ndërtesash ku ndërtimet kanë mure të jashtme rrethuese të lira. Ka dy tipe, në tokë të sheshtë dhe në tokë me pjerrrësi. Mund të arrin deri ne 3 kate me ose pa çati.

33. **"Sipërfaqe bruto e njësisë strukturore"**, është sipërfaqja brenda aksit të rrugëve që kufizojnë njësinë strukturore. Në rast se njësia strukturore nuk kufizohet nga rrugë, është sipërfaqja e territorit brenda vijës së kufirit të pronave që përfshihen në njësinë strukturore.

34. **"Sipërfaqe neto e njësisë strukturore"**, është sipërfaqja e parcelave të ndërtueshme me njësinë strukturore.

35. **"Siperfaqe kati"**, është sipërfaqja totale e katit të një ndërtimi e matur në sipërfaqen e jashtme (duke përfshirë muret e jashtme). Siperfaqe kati nuk përfshin sipërfaqet e:
    - ballkoneve;
    - tarracë gjysëm e mbuluar sipas Nenit 37 i VKM 408 dt. 13.05.2015, i ndryshuar;
    - katet përdhes (bodrumet) të cilat nuk përdoren për banim (p.sh. hapësirat për parkim nëntokësor);
    - ndërtimet e përkohshme.

36. **"Sistem territorial"**, bashkësia e një seri përbërësish territorialë për qëllime planifikimi, të ndërvarur dhe bashkëveprues me njëri-tjetrin, të cilët formojnë një tërësi.

37. **Tipologji hapësinore e ndertimit**, është karakteri i një njësie strukturore bazuar në ndërthurjen e njëtrajtshmërisë së llojit dhe volumit të strukturave, mënyrës së vendosjes së tyre në territor, skemës rrugore dhe të hapësirave publike.

38. **"Urbanizim"** procesi i ndërhyrjes në territor nëpërmjet zhvillimeve të reja, i cili sjell ndryshime të strukturës së popullsisë dhe territorit, në funksion të rritjes së sistemit urban.

39. **"Vija blu"** vija kufizuese e zhvillimit me funksion mbrojtjen e të gjitha burimeve ujore.

40. **"Vija e gjelbër"** ose kufiri i territorit urban, është perimetri që përcakton/kufizon shtrirjen territoriale të ndërtimeve në funksion të sistemit urban. Në këtë kufizim nuk hyjnë ndërtimet që janë në funksion të sistemit natyror apo bujqësor.

41. "**Vija e kuqe**" ose vija e ndërtimit të rrugës, është kufiri i lejuar për vendosjen e një ndërtimi në raport me infrastrukturën, në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi.

42. **"Zhvillim i qëndrueshëm"**, është zhvillimi social, ekonomik, territorial dhe mjedisor që u përgjigjet nevojave të brezave të sotëm dhe që nuk rrezikon, demton apo pakëson burimet për brezat e ardhshëm.

43. **"Zhvillues"**, nënkupton çdo person fizik ose juridik që investon dhe realizon një zhvillim në një zonë ose njësi ku lejohet zhvillimi.

44. **"Zona",** është një pjesë e territorit, me karakteristika ose përdorime të veçanta apo të njëjta, ekzistuese a të planifikuara të tokës e ndërtimeve në të, sipas rregulloreve të përdorimit të tokës. Zona mund të përputhet ose jo me një apo më shumë njësi strukturore të territorit.

45. **"Zonë me prioritet zhvillimi"**, është një zonë/territor, e cila përbën prioritet zhvillimi për Bashkinë, ka përmasa të krahasueshme me ato të disa njësive strukturore mesatare, sipas rastit mund të përputhet me një njësi strukturore, zgjidhet për të bërë të mundur zbatimin e Politikave vendore të planifikimit, sa i përket vizionit dhe objektivave strategjikë të zhvillimit të territorit dhe përdorimin dhe zhvillimin e tokës për projekte dhe zona të rëndësisë publike dhe vendore. Zona të tilla janë gjithmonë subjekt i një Plani të Detajuar Vendor, sipas të cilit përcaktohen tregues të njëtrajtshëm dhe të detyrueshëm zhvillimi për kërkesat për zhvillim.

46. **"Zonë e një Zhvilluesi të Vetëm"**, është një zonë e përcaktuar nëpërmjet Planit të Përgjithshëm Vendor që do të zhvillohet si një kompleks i integruar nga një zhvillues i vetëm. Koncepti i përgjithshëm i zhvillimit pasqyrohet në një PDV.

47. **"Zonim i përdorimit të tokës"**, është ndarja e një territori në zona/njësi strukturore sipas kategorive të përdorimit të tokës ose strukturave në të, për qëllime planifikimi dhe kontrolli zhvillimi të territorit.

48. *Termat e tjerë të përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ata të përcaktuar në legjislacionin në fuqi në momentin e hartimit të Rregullores, Ligji nr.107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" I ndryshuar, Vendim I Këshillit të Ministrave nr.686, datë 22.11.2017"Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", i ndryshuar, Vendimi I Këshillit të Ministrave nr.408, datë13.05.2015 "Për miratimin e rregullores se zhvillimit të territorit" I ndryshuar.*

KREU II – Administrimi i rregullores dhe territori

Seksioni I - Ligjshmëria dhe administrimi

Neni 4_Zgjidhja e Konflikteve dhe Mospërputhjeve

1. Në rast mospërputhjesh midis elementëve të këtij dokumenti, dispozitave në tekst dhe formatet tabelore kane prioritet mbi elmentet grafike.

2. Në rast mospërputhjeve të normave dhe rregulloreve të këtij dokumenti, dispozitat më kufizuese sundojnë mbi ato më pak kufizuese.

3. Në rastin e mospërputhjeve midis rregulloreve të këtij dokumenti dhe legjislacionit tjetër kombëtar, rregulloret kombëtare kanë prioritet.

Neni 5_Zgjidhja e paqartesive bazuar ne saktësinë e informacionit hapësinor

1. Atje ku kufijtë e zonës ndjekin përafërsisht kufijtë e truallit ose vijat e rrugës, kufiri me i afert i truallit ose qendres se rrugës do të konsiderohet si kufi.

2. Kur vijat kufizuese jane sipas rrjedhës ujore, ajo do të konsiderohet si vija qendrore e rrjedhës së ujit.

3. Atje ku ka paqartesi, autoritetet përkatëse te planifikimit, në bazë të një kërkese me shkrim ose me iniciativën e vet, do të përcaktojnë vendndodhjen e kufirit të zonës ku ekziston paqartësia, duke marrë vendndodhjen e treguar në Hartën e Zonimit dhe qëllimet e zonës siç përcaktohet në këtë rregullore.

Neni 6_Miratimi dhe hyrja në fuqi

1. Kryetari i njësisë vendore, si autoriteti përgjegjës për hartimin e planit, paraqet për miratim planin ose pjesët përbërëse të tij në Këshillin Bashkiak, në përputhje me nenet 12, pika 2 dhe 13 të Ligjit Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar.

2. Dokumentacioni, subjekt miratimi, shqyrtohet nga Këshilli Bashkiak, sipas listës së përcaktuar në pikën 1, të nenit 61 të VKM nr. 686 date 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar.

3. Dokumentacioni, subjekt miratimi, miratohet nga KKT-ja në përputhje me shkronjën "a", të nenit 7 të Ligjit Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar bazuar në dokumentacionin e përmendur në pikën 2, të nenit 61 të VKM nr. 686 date 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar.

4. Dokumenti i Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) apo pjesët përbërëse të tij subjekt miratimi, hyjnë në fuqi me botimin e plotë në regjistër (Regjistri Kombëtar i Planifikimit të Territorit) të vendimit të KKT-së dhe dokumenteve shoqëruese të tij, në përputhje me pikën 2, të nenit 56 të Ligjit Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar.

Neni 7_Zbatueshmëria

1. Zbatimi i rregullores është i detyrueshëm për të gjithë personat fizikë e juridikë që ushtrojnë aktivitetin e tyre, kanë pronë si dhe/ose banojnë në territorin e Bashkisë Delvinë sipas sipërfaqes dhe kufirit të përcaktuar në vijim.

Neni 8_Shfuqizimi

1. Rregullorja shfuqizohet vetëm me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit.

Neni 9_Amendimi

1. Planet e përgjithshme janë objekt ndryshimi, kur është e nevojshme, sipas pikës 2, të Nenit 26 "Rishikimi i planeve", Ligji Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar dhe në çdo rast objekt rishqyrtimi të plotë çdo 15 vjet. Procesi për shqyrtimin e plotë të tyre fillon 2 vjet para përfundimit të afatit të sipër përmendur, sipas së njëjtës procedurë të ndjekur për miratimin e tyre.

2. Rishikimi i dokumentit të planifikimit kryhet në përputhje me nenin 26, të Ligjit Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar, për shkak të forcave madhore, si: tërmete, përmbytje, zjarre masive, rrëshqitje të tokës, erozion etj., të ngjashme, për shkak të ndarjeve administrative e territoriale, ndryshimeve të paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshimeve të shkaktuara nga kriza sektoriale, si edhe kur lind nevoja e harmonizimit me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të menaxhimit të territorit, si dhe për arsye të përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

3. Për çdo rast të ndryshimit të dokumentit të planitfikimit, argumentimit do t'i bashkangjitet një raport i cili shpjegon teknikisht çështjet dhe arsyet përkatëse për ndryshimin e kërkuar. Raporti përgatitet dhe dorëzohet pranë autoriteteve miratuese.

Neni 10_Proçedura e thjeshtuar për rishikimin e dokumentit të planifikimit

1. Në disa raste, procesi i rishikimit të dokumentit të planifikimit realizohet duke ndjekur një procedurë të thjeshtuar, e cila ka për qëllim të shkurtojë afatet e procesit të planifikimit, këshillimit e të bashkërendimit, të përjashtojë miratimin e nismës dhe të trajtojë vetëm pjesët e dokumentit të planifikimit, subjekt rishikimi, në varësi të rastit dhe nevojave.

2. Procedura e thjeshtuar ndiqet kur rishikimi i dokumentit të planifikimit bëhet për një pjesë të territorit dhe përmbushen kriteret e mëposhtme:
   a) Dokumentet e planifikimit ndryshohen për çështje që nuk cënojnë vlerat natyrore e mjedisore, zonat e mbrojtura dhe trashëgiminë historike e kulturore;
   b) Rishikimi nuk shoqërohet me ndryshime të strategjisë territoriale;
   c) sipas pikës 2 të nenit 26 të ligjit.

Neni 11_Instrumentat dhe lejet e miratuara para hyrjes në fuqi

1. Planet e Detajuara Vendore dhe Lejet e Ndërtimit të miratuara në zbatim të dokumenteve të planifikimit të mëparshme, të cilave nuk u ka mbaruar afati i zbatimit, mbeten në fuqi.

Neni 12_Administratori I rregullores

1. Për qëllimet e kryerjes së detyrave të veçanta të administrimit të Rregullores përcaktohet Departamenti i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZHT), i njohur si Autoriteti Vendor i Planifikimit. Drejtuesi i DPZHT Delvinë caktohet administrator i Rregullores me përgjegjësinë e plotësimit të detyrave të veçanta. Administrimi i Rregullores përfshin por nuk kufizohet në detyrat e mëposhtme:
   - Mbajtjen e një kopje zyrtare të Rregullores;
   - Përditësimin e kopjes zyrtare të dokumentit të Rregullores për të reflektuar çdo amendim, dhe publikimin në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit;
   - Mbajtjen e inventarit të të gjitha materialeve që lidhen me Rregulloren si harta, amendimet, raportet teknike, etj;
   - Përgatitjen e argumentimit për amendim;

Seksioni II – Autoritetet e planifikimit dhe juridiksioni i planit

Neni 13_Autoritetet e planifikimit

1. Autoritetet vendimmarrëse janë të nivelit vendor dhe kombëtar.
   - Autoriteti kombëtar vendimmarës është Këshilli Kombëtar i Territorit, i cili funksionon pranë Këshillit të Ministrave dhe drejtohet nga Kryeministri. Plani i Përgjithshëm Vendor si dhe projektet që prekin çështje apo zona të rëndësisë kombëtare miratohen nga KKT.
   - Autoritetet vendore vendimmarrëse janë: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak.
   - Këshilli Bashkiak miraton Planin e Përgjithshëm Vendor.
   - Kryetari i Bashkisë miraton lejen e zhvillimit/ndërtimit.
   - Kryetari i Bashkisë miraton planet e detajuara vendore.

Neni 14_Kufijtë e juridiksioninit të planit

1. Kjo rregullore zbatohet në sipërfaqen e zonës së trajtuar nga Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV) i Bashkisë Delvinë. Kjo sipërfaqe është e përcaktuar nga bashkësia e njësive strukturore të PPV-së së Bashkisë Delvinë dhe kufizohet nga kufiri

administrativ i saj, i përcaktuar me Ligjin nr.115/2014 datë 31.07.2014 "Për ndarjen administrativo territoriale të njësive të qeverisjes vendore ne Republikën e Shqipërisë".

2. Sipërfaqja e territorit në juridiksion të planit përfshin gjithë territorin administrativ të Bashkisë Delvinë si më poshtë:

Njësia administrative	Sipërfaqe (ha)
Delvinë	6345.84
Vergo	15824.97
Total	**22170.82**

3. Në çdo rast për sipërfaqen e saktë të territorit të Njësive Administrative, është e detyrueshme referimi në të dhënat zyrtare të Ministrisë së Brendshme.

KREU III – Rregullat e përdorimit të tokës

Seksioni I – Sistemet, kategoritë bazë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës

Neni 15_Sistemet territoriale

1. Kategoritë bazë të përdorimit të tokës dhe të strukturave në të, përcaktohen sipas pesë sistemeve territoriale, në zbatim të definicioneve të Nenit 75 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", i ndryshuar":
   a. Sistemi urban "**UB**";
   b. Sistemi natyror "**N**";
   c. Sistemi bujqësor "**B**";
   d. Sistemi ujor "**U**";
   e. Sistemi infrastrukturor "**IN**";

2. Në çdo rast, përfshirja e një strukture apo përdorimi tokë në një sistem lidhet ngushtë me funksionin e strukturës dhe parcelës apo parcelave.

Neni 16_Kategoritë bazë të përdorimit të tokës (sipas Neni 80 i VKM 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", i ndryshuar)

1. Kategoritë e përdorimit të tokës dhe te strukturave në të, shërbejnë si referencë në proçesin e zonimit sipas përdorimit të tokës, të kryer nga autoriteti i planifikimit. Përcaktimi i tyre bëhet në zbatim të definicioneve të sipas Nenit 80 i VKM 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", i ndryshuar.

2. Autoriteti i planifikimit, i referohet dhe përdor gjatë procesit të zonimit sipas përdorimit të tokës dhe strukturave në të, këto kategori dhe kode:

Sistemi	Nr.	Kodi	Kategoria e Përdorimit të Tokës	Përshkrimi
U	1	A	**Banim**	përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksione dhe aktivitete të banimit
	2	S	**Shërbime**	përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e shërbimeve tregtare, akomoduese dhe zyre
	3	IE	**Industri Ekonomi**	përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e industrisë së lehtë e të rëndë, si dhe funksione ekonomike komplekse
	4	IS	**Institucione**	përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e administrimit publik, shërbimeve publike, sociale, diplomatike, financiare dhe fetare
	5	AS	**Arsim**	përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e arsimit në të gjitha nivelet: parashkollor, i ulët, i mesëm dhe i lartë, sipas legjislacionit përkatës
	6	SH	**Shëndetësi**	përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet e shërbimit ambulator dhe spitalor, sipas legjislacionit përkatës
	7	SHA	**Aktivitete Shoqërore & Argëtimi**	përfshin territore dhe struktura në shërbim të aktiviteteve kulturore e sportive, parqe dhe hapësira publike
	8	M	**Monumente**	përfshin territore dhe struktura, pjesë të trashëgimisë kulturore dhe historike
	9	ZU	**Zona ushtarake**	përfshin territore dhe struktura ku kryhen funksionet dhe aktivitetet ushtarake, sipas legjislacionit përkatës
	10	V	**Varrezë**	përfshin territoret dhe strukturat në shërbim të varrezave
I	11	INT	**Infrastrukturë Transporti**	përfshin infrastrukturat e transportit rrugor, hekurudhor, ujor, ajror dhe multimodal; rrjetet e përbëra nga linjat, stacionet dhe struktura të tjera në shërbim të tyre

	12	IEN	**Infrastrukturë Energjetike**	përfshin infrastrukturat e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nga burime hidrike, lëndë djegëse, eolike e diellore, si dhe infrastrukturat e gazifikimit, përfshirë linjat dhe strukturat mbështetëse
	13	ITK	**Infrastrukturë Telekomunikacioni**	përfshin rrjetet, antenat dhe strukturat që mundësojnë telekomunikacionin
	14	IUK	**Infrastrukturë Ujësjellës - Kanalizime**	përfshin rrjetet dhe strukturat në shërbim të furnizimit me ujë, kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të zeza
	15	IMB	**Infrastrukturë Menaxhimi Mbetjesh**	përfshin strukturat në shërbim të grumbullimit, depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta
B	16	B	**Tokë Bujqësore**	përfshin tokat bujqësore me kultura të përhershme apo sezonale bujqësore, si dhe tokat djerrë, sipas legjislacionit përkatës
	17	IB	**Infrastrukturë Bujqësore**	përfshin infrastrukturën në shërbim të aktivitetit bujqësor që mundëson vaditjen dhe kullimin e tokave bujqësore
	18	EB	**Ekonomi Bujqësore**	përfshin strukturat dhe infrastrukturat në funksion të ekonomisë bujqësore e blegtorale, si dhe shërbimet e agroturizmit
	19	BA	**Bujqësi - Banim**	përfshin banimin në funksion të aktivitetit bujqësor
N	20	N	**Tokë Natyrore**	përfshin territoret natyrore, si: pyje, kullota, livadhe, shkurre e të tjera, të paprekura nga aktiviteti njerëzor
	21	NAR	**Natyrë dhe Argëtim**	përfshin territoret natyrore, infrastrukturat ekologjike në funksion të aktivitetit njerëzor në natyrë, si: parqe, plazhe, shtigje dhe strukturat në funksion të ekoturizmit
U	22	U	**Ujëra**	përfshin të gjithë trupat ujorë: dete, laguna, këneta, liqene, lumenj, përrenj e burime ujore, sipas legjislacionit përkatës

Neni 17_Nënkategoritë e kategorisë bazë të përdorimit të tokës

1. Nënkategoritë e përdorimit të tokës dhe te strukturave në të, përcaktohen në zbatim të definicioneve të Nenit 80 i VKM 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", i ndryshuar.

2. Autoriteti i planifikimit, i referohet dhe përdor gjatë procesit të zonimit sipas përdorimit të tokës dhe strukturave në të, këto nënkategori dhe kode:

Kodi	Kategoria	Nr.	Kodi	Nënkategoria
A	Banim	1	A1	Banim
		2	A2	Banim dhe Shërbime
S	Shërbime	3	S1	Shërbime Akomodimi dhe Argëtimi
		4	S2	Shërbime Tregtare dhe Biznesi
IE	Industri Ekonomi	5	IE1	Industri e Lehtë
		6	IE2	Industri e Rëndë
		7	IE3	Aktivitet Ekonomik Kompleks
IS	Institucione	8	IS2	Shërbim Publik
		9	IS3	Shërbim Social
		10	IS4	Shërbim Diplomatik
		11	IS5	Institucione Financiare
		12	IS6	Institucion Fetar
AS	Arsim	13	AS1	Arsim Parashkollor
		14	AS2	Arsim i Ulët
		15	AS3	Arsim i Mesëm
		16	AS4	Arsim i Lartë
SH	Shëndetësi	17	SH1	Shërbim Ambulator
		18	SH2	Shërbim Spitalor
SHA	Aktivitete Shoqërore & Argëtimi	19	AR1	Hapësira Publike
		20	AR2	Aktivitete Kulturore
		21	AR3	Aktivitete Sportive dhe Rekreative
M	Monumente	22	M1	Monument Kulture
ZU	Zona ushtarake	23	ZU1	Infrastrukturë Ushtarake
V	Varrezë	24	V1	Varrezë
		25	V2	Varrezë Dëshmorësh
		26	V3	Memorial
INT	Infrastrukturë Transporti	27	INT1	Infrastrukturë Rrugore
		28	INT2	Infrastrukturë Hekurudhore
		29	INT3	Infrastrukturë Transporti Ujor
		30	INT4	Infrastrukturë Transporti Ajror
		31	INT5	Infrastrukturë Multimodale

IEN	Infrastrukturë Energjetike	32	**IEN1**	Elektrike
		33	**IEN2**	Hidrike
		34	**IEN3**	Hidrokarbure
		35	**IEN4**	Eolike
		36	**IEN5**	Diellore
ITK	Infrastrukturë Telekomunikacioni	37	**ITK1**	Stacion Telekomunikacioni
		38	**ITK2**	Antena
IUK	Infrastrukturë Ujësjellës - Kanalizime	39	**IUK1**	Ujësjellës
		40	**IUK2**	Kanalizime
IMB	Infrastrukturë Menaxhimi Mbetjesh	41	**IMB1**	Trajtim Mbetjesh
		42	**IMB2**	Depozitim Mbetjesh
B	Tokë Bujqësore	43	**B1**	Kultura të Përhershme
		44	**B2**	Kultura Sezonale
		45	**B3**	Tokë Djerrë
IB	Infrastrukturë Bujqësore	46	**IB3**	Infrastrukturë Vaditje dhe Kullimi
EB	Ekonomi Bujqësore	47	**EB1**	Struktura në Funksion të Bujqësisë
		48	**EB2**	Struktura në Funksion të Blegtorisë
		49	**EB3**	Agroturizëm
BA	Bujqësi - Banim	50	**BA1**	Bujqësi - Banim
N	Tokë Natyrore	51	**N1**	Pyje
		52	**N2**	Kullotë
		53	**N3**	Livadh
		54	**N4**	Shkurre
		55	**N5**	Tokë Pa Frut
NAR	Natyrë dhe Argëtim	56	**NAR1**	Park Natyror
		57	**NAR2**	Plazh
		58	**NAR3**	Shtigje
		59	**NAR4**	Ekoturizëm
U	Ujëra	60	**U1**	Det
		61	**U2**	Lagunë
		62	**U3**	Kënetë
		63	**U4**	Liqen
		64	**U5**	Lumë
		65	**U6**	Përrua
		66	**U7**	Burim ujor

Seksioni II – Aktivitetet dhe funksionet në përputhje me kategoritë e përdorimit të tokës

Neni 18_Tipologjitë e strukturave

1. Kategoritë bazë të përdorimit të tokës dhe te strukturave në të, shërbejnë si referencë në proçesin e zonimit sipas përdorimit të tokës, të kryer nga autoriteti i planifikimit. Përcaktimi i tyre bëhet në zbatim të definicioneve të Nenit 80 i VKM 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", i ndryshuar.

2. Autoriteti i planifikimit, i referohet dhe përdor gjatë procesit të zonimit sipas përdorimit të tokës dhe strukturave në të, këto tipologji strukturash:

   a) **Struktura individuale**, që në Delvinë dhe në qendrat kryesore rurale karakterizohen nga një dendësi e ulët dhe e mesme, nga parcela të vogla me ose pa oborr dhe në lokalitetet e
   tjera karakterizohen nga një dendësi e ulët, oborre të mëdha, ku në parcelë krahas oborrit
   ka dhe pjesë toke të punuar individuale. Strukturat mund të jenë:
   1. Struktura Individuale të Veçuara
   2. Struktura Individuale të Grupuara

   b) **Struktura Kolektive** me dendësi të ulët (struktura që përfshijnë disa njësi familjare deri në
   15 njësi familjare), të mesme dhe të lartë banimi (më shumë se 15 njësi familjare) dhe
   shërbimesh kryesisht në katet përdhese, karakteristikë e zonave urbane të zhvilluara me
   plane të mirëfillta urbanistike ose në proces formulimi si urbanizime apo rizhvillime të reja.
   Strukturat mund të jenë:
   i. Vila / Pallate të grupuara

3. Në sistemin urban, kategoritë e tjera si: Shërbime (S), Industri Ekonomi (IE), Institucione (IS), Arsim (AS), Shëndetësi (SH), Aktivitete Shoqërore & Argëtimi (SHA) kanë tipologji tipike që rrjedhin nga funksioni kryesor. Këto struktura mund të jenë:
   i. Struktura lineare
   Në çdo rast në këtë kategori, veçanërisht në afërsi të Kategorisë Monumentet (M) duhet të marrin në konsideratë elementët arkitektonikë dhe parametrat urbanë të strukturave ekzistuese përreth.

4. Tipologjia e kategorisë Monument (M) është në varësi të funksioneve të objektit Pasuri Kulturore.

Neni 19_Tipologjitë e ndërhyrjes në territor

1. Tipologjitë e ndërtimit paraqesin mënyrën e ndërhyrjes për ruajtjen, përmirësimin apo ndryshimin e gjendjes duke u mbështetur në elemente sasiorë dhe cilësorë të matshëm dhe kontrollueshëm. Në çdo rast tipologjitë e lejuara të strukturave do të jenë gjithmonë në përputhje me tipologjinë hapësinore të përcaktuar në PPN.

2. Në të gjitha rastet e hatimit të PDV-ve do të respektohet kodi i tipologjive të ndërhyrjeve për çdo zonë/ njësi strukturore referuar tabelave përkatëse të treguesve të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

   a) **Dendësim/Konsolidim Urban: Kodi [DENDES]** është proçesi i densifikimit dhe mbushjes urbane të njësisë strukturore apo të një a më shumë pjesëve të saj, të cilat janë të zhvilluara në mënyrë homogjene, sa i përket kushteve të zhvillimit, ndërtimeve në territor, si dhe rrjetit rrugor e infrastrukturor.Kjo mënyrë ndërhyrjeje synon përdorimin sa më efiçent të tokës truall si dhe rrjeteve të infrastrukturave publike. Vlen vetëm për zonat urbane ekzistuese dhe duke iu referuar zonave relativisht të vogla të tokës vakante në mes të territoreve të urbanizuara ose pjesërisht të urbanizuara. Ato zakonisht nuk kërkojnë një PDV. Mbushja urbane nënkupton zhvillimin e parcelave bosh/të pandërtuara me ndërtime të reja, me tregues zhvillimi të ngjashëm me ato të gjithë zonës, që do të thotë se treguesit në nivel parcele ngelen të njëjtë me treguesit që mbizotërojnë në zonë, ndërsa treguesit në nivel njësie do të rriten si pasojë e dendësimit. Kjo lloj ndërhyrjeje nuk ndryshon në asnjë rast karakterin dhe tipologjinë e ndërtimit. Ndërhyrjet infrastrukturore janë përmirësuese, por jo thelbësore.

   b) **Konservimi Urban, Historik dhe Natyror / Kodi: [KONSERV]** Konservimi ka dy aplikime të ndyshme duke ju referuar urbanizimit dhe territorit natyror. Konservimi urban nënkupton ruajtjen e karakterit, tipologjive dhe përdorimit ekzistues të zonave të caktuara të qytetit dhe fshtrave. Shkalla e ndërhyrjeve në lidhje me rritjen e intensitetit dhe strukturat e ndërtimit është minimale, ndaj treguesit e propozuar përputhen ose janë përafërsisht të barabartë me ato të gjendjes ekzistuese. Në qytet dhe qendrat e fshtarave ndërhyrjet nënkuptojnë rehabilitimin e infrastrukturave, shërbimeve publike, banesave, elementëve të dezainit urban. Këto ndërhyrje aplikohen në zonat e kompleksève të banimit me koncepte hapësinore të qarta të ndërtuara para viteve '90. Për Bashkinë e Delvinës Konservimi Urban i referohet:
      - Të gjitha zonat e banimit te fshatrave (A1)
      - Zonat e organizuara/përfitues të aktiviteteve ekonomike (IE1,2,3)
      - Monumenteve të trashëgimisë kulturore (M1).

      Konservimi natyror i referohet territoreve brenda Sistemit Natyror dhe sistemit të ujit, të cilat formojnë burime të vlefshme natyrore të bashkisë që meritojnë të jenë të mbrojtur nga zhvillimi. Janë të përfshira në këtë kategori kombëtare zona të mbrojtura sipas legjislacionit ne fuqi (N, NAR, U) dhe zonat e mbrojtura të propozuara nga PPV duke ju referuar kategorive të zonimit. Në Delvinë fushat kryesore të destinuara për Konservim Natyror janë:
      - Rezervati Natyror i Menaxhuar i Rrëzomës;
      - Zona natyrore e Pyllit të Gështenjave

Koncepti i Konservimit është aplikuar edhe në zona të tjera të cilat nuk i përkasin sistemit natyror dhe ujor, por janë të mbrojtura nga zhvillimi me anë të zonimit të
tyre të caktuar nga PPV, përkatësisht:

- Toka bujqësore e kategorive (B) nën Konservimi Bujqesor me kuptimin e mbrojtjes së përdorimit të tokës për qëllime bujqësore.
- Sipërfaqet e gjelbra dhe hapësirat publike, pyjet përreth (AR)

c) **Rigjenerim/ Ripërtëritje: Kodi [RIGJEN]** Nënkuptohet ringjallja, rikthimi i funksineve të mëparshme, ose rehabilitimi, rikthimi i vetive natyrale peizazhistike i zonave te degraduara të cilat në gjendjen aktuale e kanë humbur atë. Shkalla e ndërhyrjeve në këto zona varion që nga ndërhyrjet ndërtimore e deri tek sistemimet e terrenit, krijimi i brezave të gjelbër, apo trajtimet peisazhistike për të ritheksuar vlerat estetike të qytetit dhe fshtrave. Rikualifikimi ekonomik zbatohet në zona ekonomike të cilat kanë degraduar por nga pozicioni i tyre në qytet, mbeten përsëri të rëndësishme për të funksionuar si të tilla.Rikualifikimi ambjental peizazhistik zbatohet në territore të lira të cilat për efekte ambientale apo peizazhistike propozohen të kthehen në breza të gjelbër sanitar dhe rekreativ. Koncepti i rikualifikimit i referohet kontekstit të sistemeve natyrore dhe bujqësore.

- Rikualifikimi në sistemin urban synon të realizojë përmirësimin e cilësisë së mjedisit urban, duke u fokusuar kryesisht në hapësirat dhe burimet publike;
- Rikualifikimi në sistemin natyror i referohet konceptit të rehabilitimit te peizazhit dhe natyrës në rastet e zonave me dëmtime mjedisore ose zona të degraduara;
- Rikualifikimi në sistemin e bujqësisë i referohet rastit të tokës së papunuar si dhe tokes pa frut.

Për Bashkinë e Delvinës fushat kryesore të destinuara për Rigjenerim / Rikualifikim janë:

- Zonat urbane Akupunture - (AR1, AR2 dhe AR3);
- Agroturizmit dhe zonat caktuar për ekoturizmëm (EB3 dhe NAR4);

d) KONSOLIDIM: **Kodi [KONSOL]** - Nxitja e ndërtimit brenda zonave të urbanizuara, me qëllim mbrojtjen e tokave bujqësore dhe përforcimin e struktura urbane territorial. Konsolidim si mënyrë ndërhyrjeje vlen për pjesën më të madhe të zonave ekzistuese rurale të banuara dhe zonat ekonomike ekzistuese apo të propozuara. Nëpërmjet konsolidimit arrihet përforcimi i strukturës urbane të atyre zonave, të cilat kanë një skelet hapësinor, ose fillesa të mirëpërcaktuara.

e) **Rizhvillim: Kodi [RIZHVIL]** Është një veprim në procesin e planifikimit, në njësitë me dendësi të mesme deri të lartë banimi dhe përdorimi, i cili ka për qëllim të rivlerësojë treguesit e zhvillimit të njësisë. Kryhet në zona të pazhvilluara më parë, duke ndryshuar tërësisht strukturën e ndërtimeve ekzistuese, funksionet e

tyre dhe/ose treguesit e zhvillimit (Intensitet, Ksht, Kshr, Kshp).. Për Bashkinë e Delvinës fushat kryesore të destinuara për Rizhvillim janë:

- Magazinat e braktisura bujqësore dhe ekonomike në hyrje të qytetit të Delvinës (IE1).

f) **Urbanizim Kodi: [URBAN]** Eshtë procesi i ndryshimit të territorit nga përdorim rural në urban. Urbanizimi është i lidhur me rritjen graduale të përqindjes së popullsisë që jeton në zonat urbane dhe mënyrat në të cilat çdo shoqëri i përshtatet këtij ndryshimi. Ky proces ka filluar në Shqipëri kryesisht në periudhën pas viteve 1990 deri në fillim të viteve 2000 dhe ka kryer një ndryshim të rëndësishëm të përdorimit të tokës nga bujqësore dhe natyrore në favor të sistemeve urbane. Në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm demografik dhe mbrojtjen e tokës primare bujqësore dhe natyrore janë propozuar për urbanizimin zona shumë të vogla përmes PPV. Procesi i urbanizimit në kontekstin e zonës së studimit për Bashkinë Delvinë i referohet kryesisht zonave të propozuara për zhvillime :

- Zona të kufizuara per zhvillime rezidenciale, qe nuk perbejne token primare bujqesore (A1, A2).

Neni 20_Kategoritë e lejuara të përdorimit të tokës dhe strukturave në të

1. Kategoritë e lejuara të përdorimit të tokës dhe strukturave në të për një zonë të caktuar, vlerësohen kategoritë e zhvillimeve të lejuara në atë zonë sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje për kategoritë bazë dhe në perputhje me instrumentet e planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit në fuqi.

2. Për çdo njësi strukturore, janë përcaktuar "*përdorime të tjera të lejuara*". Këto lloj përdorimesh realizohen vetëm për disa nen-kategori sipas rastit dhe deri në atë masë që mund të akomodojë kapaciteti mbajtës i zonës, në çdo rast ato nuk mund të jenë në asnjë mënyrë kategoritë e ndaluara.

3. Kategoritë e lejuara të përdorimit të tokës dhe strukturave në të:
   - ndajnë përkatësisht përfitimet e ndërsjella;
   - nuk bien në kundërshtim me qëllimin e zonimit, me funksionet dhe me natyrën e kategorive bazë të përdorimit të tokës dhe të strukturave në të në një zone;
   - përputhen me kushtet e vendosura nga dispozitat ligjore në fuqi dhe nga instrumentet e planifikimit në fuqi, për sigurinë e mjedisit, të shëndetit, të tokës bujqësore dhe të vlerave historike dhe kulturore për përdorimet dhe funksionet ekzistuese dhe të autorizuara në zonën përkatëse dhe në zonat fqinjë në kufi.

4. Për zonat dhe njësitë në sistemin urban lejohen, për zonat dhe njësitë me përdorim toke A1 dhe A2: hapësira parkimi, zona të gjelbra dhe infrastruktura themelore sociale (p.sh. arsimi, shëndetësia), infrastruktura sociale dhe argëtimi, të gjitha shërbimet bazë (kafene, farmaci, zyra, parukeri, furra buke, pika karburanti - lavazha

etj.) si dhe infrastruktura teknike urbanistike (p.sh. rezervuarë uji, kabina elektrike), duke aplikuar legjislacionin sektorial.

5. Në zonat me nënkategori të përdorimit të tokës AR1, lejohen objekte ndihmëse dhe komplementare (p.sh. pika tregtimi pijesh freskuese, tualete, mjedise sportive) në një sipërfaqe të kufizuar (p.sh. 10%).

6. Në zonat me nënkategori të përdorimit të tokës AR3, lejohen objekte ndihmëse dhe infrastruktura të kufizuara dhe absolutisht të nevojshme (p.sh. dhoma ndërrimi, shkallë për të ndenjur).

7. Për zonat dhe njësitë në sistemin natyror lejohen instalimet infrastrukturore teknike (p.sh. të transportit, furnizimit me ujë, kanalizimeve, telekomunikacionit, energjisë) në përputhje me legjislacionin përkatës.

8. Për zonat dhe njësitë në sistemin natyror lejohen nën kushte të caktuara (kur janë si përdorim ekzistues në territor por zonimi është pjesë e sistemit Natyror dhe kur propozohen të tilla nga institucionet përkatëse qëndrore) përdorimet e mëposhtme (a) të sistemit urban: M-Monumente, V-Varreza, ZU-Zona ushtarake dhe (b) të sistemit bujqësor: IB-Infrastruktura bujqësore dhe B-Toka bujqësore.

9. Në zonat që përdorin NAR1.1 lejohen objekte ndihmëse dhe plotësuese (p.sh. pika tregtimi pijesh freskuese, tualete, baza sportive) në sipërfaqe të kufizuar dhe në mënyrë të pajtueshme që nuk dëmton mjedisin.

10. Në zonat dhe njësitë strukturore pjesë e Sistemit Bujqësor, për të gjithë kategoritë / nënkategoritë e tokës, lejohen ato kategori përdorimi toke, të cilat janë pjesë e sistemit Infrastrukturor dhe që I shërbejnë fuksionit primar të zonës/njësisë.

11. Në zonat dhe njësitë strukturore pjesë e Sistemit Bujqësor lejohen, në kushte të caktuara, përdorimet e mëposhtme të sistemit urban: M-Monumente, V-Varreza dhe ZU-Zona ushtarake.

12. Në zonat dhe njësitë strukturore pjesë e Sistemit Ujor, për të gjithë kategoritë / nënkategoritë e tokës, lejohet infrastruktura teknike e kategorive të përdorimit të tokës në vijim: IEN - Infrastrukturë energjetike, INT- Infrastrukturë transporti, IUK- Infrastrukturë ujesjelleskanalizime.

13. Në zonat dhe njësitë strukturore pjesë e Sistemit Ujor, peshkimi dhe aktivitete të tjera ekonomike dhe rekreative (p.sh. sportet) lejohen sipas legjislacionit sektorial të zbatueshëm.

14. Në zonat dhe njësitë strukturore, të cilat nuk janë pjesë e Sistemit Infrastrukturor, por që në momentin e miratimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Delvinë, brenda territorit të tyre janë të ndërtuara elemente pjesë e Sistemit Infrastrukturor, ato lejohen në përdorimin e tokës, por pa ndryshuar në funksion apo

sipërfaqe. Elementë të tillë mund të jenë, por pa u kufizuar: Antena Telekomunikacioni, Transformator, Burim Ujësjellësi, Depo uji, Stacion Pompimi.

Neni 21_Kategoritë e Ndaluara të përdorimit të tokës dhe strukturave në të

1. Kategoritë e ndaluara të përdorimit të tokës dhe të strukturave në të për një zonë të caktuar, vlerësohen zhvillimet e ndaluara në atë zonë, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje për kategoritë bazë dhe në përputhje me instrumentet e përgjitshme të planifikimit ne fuqi.

2. Kriteret për përcaktimin e zhvillimeve të ndaluara në një zonë, por pa u kufizuar vetëm në to, janë:
   - kategoritë e përdorimit të tokës që bien në kundërshtim me qëllimet e zonimit sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje dhe instrumenteve të planifikimit në fuqi;
   - kur një zhvillim kërkohet të realizohet në një zonë që i përket një kategorie bazë të ndryshme nga ajo e zhvillimit të kërkuar, për sa kohë qënuk parashikohet ndryshe dhe në mënyrë të argumentuar në instrumentin e planifikimit në fuqi;
   - çdo përdorim që pavarësisht nga kategoria bazë të cilës i përket, krijon ndotje në mjedis përtej parametrave dhe standardeve të parashikuara në legjislacionin e posaçëm mjedisor, dëmton shëndetin, dëmton strukturat dhe objektet e pasurisë kulturore;
   - çdo zhvillim në tokë bujqësore që edhe pse mund të jetë brenda kategorisë bazë të përdorimit të tokës dhe strukturës në të, nuk respekton rregullat, standardet dhe treguesit e planifikimit dhe të zhvillimit sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje dhe te instrumenteve të planifikimit në fuqi;

   Përdorime të ndaluara janë ato që përcaktohen për çdo njësi strukturore/ zonë me prioritet zhvillimi në këtë Rregullore. Si rregull i përgjithshëm, përveç sa përcaktohet ndryshe në këtë rregullore:
   - përdorimet e ndaluara përmbushin përcaktimet e rregullores së planifikimit të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave;
   - përdorime të ndaluara për zonat e banimit janë: industritë e rënda, kimike dhe të tjera ndotëse me ndikim të lartë në mjedis; ndërtimet ushtarake; varrezat; impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura; landfill-et; incineratorët; parcelat komunitare të kompostimit të mbetjeve organike;
   - aktivitetet e zonës rurale, pavarësisht shkallës, si rritja e bletëve, mbajtja e bagëtive dhe gjedhëve, etj., të ngjashme janë të ndaluara në zona urbane. Lejohen vetëm aktivitete të kultivimit dhe ortikulturës në oborret dhe kopshtet individuale të ndërtesave, në kuadër të bujqësisë urbane;
   - nuk lejohen aktivitete si djegia e mbeturinave të çfarëdo lloji në zonat e sistemit urban, të sistemit natyror apo në brigjet e burimeve ujore;
   - përdorimet industriale janë të ndaluara të vendosen në brigjet ujore, në zonën buferike të zonave të mbrojtura natyrore pavarësisht kategorive, në zonat që mbrohen nga legjislacioni për pasuritë kulturore, përfshirë zonat buferike apo brezat mbrojtës të këtyre zonave/objekteve;

- përdorimet e ndaluara në territoret e zonave të mbrojtura natyrore dhe në zonat e tyre buferike, si dhe në zonat që mbrohen nga legjislacioni për trashëgiminë kulturore, përfshirë brezat mbrojtës/zonat buferike të këtyre zonave/objekteve, përcaktohen në legjislacionin sektorial në fuqi;
- të gjitha funksionet janë të ndaluara në hapësirën e përcaktuar si brez mbrojtës/përkatësie, apo tampon/buferik për infrastrukturën rrugore dhe kanalet e kullimit dhe vaditjes nga legjislacioni në fuqi.

3. Në zonat që janë përcaktuar nënkatëgoritë A1 dhe A2 të përdorimit të tokës ndalohen nënkategoritë e mëposhtme të përdorimit të tokës: V1-Varrezë, ZU1-Infrastruktura ushtarake, IE2-Industri e Rëndë.

4. Në zonat dhe njësitë strukturore pjesë e Sistemit Bujqësor, për të gjithë kategoritë / nënkategoritë e tokës, ndalohen ato kategori përdorimi toke, të cilat nuk janë pjesë e sistemit Bujqësor dhe nuk I shërbejnë apo janë të papërshtarshme. Këtu përfshihen por nuk janë të kufizuara, funksionet si: Industri e rëndë, Industri e lehtë, Impiant I trajtimit të ujërave të zeza, pika transferimi të mbetjeve.

5. Në zonat dhe njësitë strukturore pjesë e Sistemit Natyror, për të gjithë kategoritë / nënkategoritë e tokës, ndalohen ato kategori përdorimi toke, të cilat nuk janë pjesë e sistemit natyror dhe nuk I shërbejnë apo janë të papërshtarshme. Këtu përfshihen por nuk janë të kufizuara, funksionet si: Industri e rëndë, Industri e lehtë, Impiant I trajtimit të ujërave të zeza, pika transferimi të mbetjeve.

6. Në zonat dhe njësitë strukturore pjesë e Sistemit Ujor, për të gjithë kategoritë / nënkategoritë e tokës, ndalohet nxjerrja e materialeve inerte nga trupat ujore.

Neni 22_Kategoritë e kushtëzuara të përdorimit të tokës dhe të strukturave në të

1. Kategoritë e kushtëzuara të përdorimit të tokës dhe të strukturave në të për një zonë të caktuar, vlerësohen zhvillimet jo të ndaluara realizimi i të cilave lejohet përmes plotësimit të kushteve shtesë ose të reja në kërkesën përkatëse për zhvillim dhe në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje dhe të rregulloreve të planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit në fuqi.

2. Në çdo rast, edhe nëse autoriteti i planifikimit nuk e ka përcaktuar paraprakisht nëse një zhvillim është i lejuar, i ndaluar ose i kushtëzuar, ose nuk ka parashikuar kushte shtesë për zhvillimin e kushtëzuar, ai mund t`i kërkojë zhvilluesit të përgatitë një studim të ndikimit nga zhvillimi para se të vendosë për lejimin ose jo të zhvillimit. Përdorime të kushtëzuara janë ato që përcaktohen për çdo njësi strukturore/ zonë me prioritet zhvillimi në këtë Rregullore. Si rregull i përgjithshëm, përveç sa përcaktohet ndryshe në këtë rregullore:
   - përdorimet e kushtëzuara përmbushin përcaktimet e rregullores së planifikimit të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave;
   - pikat e furnizimit të karburantit lejohen në zonë urbane vetëm pasi plotësojnë kushtet e distancave prej të paktën 60 m nga ndërtimet e tjera të

çdo lloji, pajisen me lejen mjedisore përkatëse dhe institucioni përgjegjës miraton Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis;

- djegia e mbeturinave organike të aktivitetit bujqësor në tokë bujqësore është aktivitet i kushtëzuar. Lejohet vetëm pas vlerësimit të rriskut të ndotjesnga bashkia dhe kur pika e djegies është të paktën 300 metra nga ndërtimi më i afërt, pavarësisht funksionit të tij;
- industria e përpunimit dhe paketimit të produkteve ushqimore është aktivitet i kushtëzuar në zonë banimi dhe/ose në zonat fqinjë me ato të banimit, si dhe lejohet vetëm pasi plotëson kushtet e distancave nga ndërtimet e tjera, pajiset me lejen mjedisore përkatëse dhe institucioni përgjegjës miraton Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. Kjo industri është e kushtëzuar edhe në territoret e sistemeve urbane dhe natyrore, apo në brigjet ujore dhe lejohet vetëm pasi plotëson kërkesat ligjore sektoriale të ujërave, mjedisit, tokës bujqësore, pyjeve de kullotave, zonave të mbrojtura natyrore dhe biodiversitetit;
- përdorimet e kushtëzuara në territoret e zonave të mbrojtura natyrore dhe në zonat e tyre buferike, si dhe në zonat që mbrohen nga legjislacioni për trashëgiminë kulturore, përfshirë brezat mbrojtës/zonat buferike të këtyre zonave/objekteve,përcaktohen rast pas rasti në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi. Kushtet përcaktohen në legjislacionin në fuqi.

3. Zonat dhe njësitë në sistemin urban:
   - Në zonat që është përcaktuar nënkatëgori A2 të përdorimit të tokës në të gjitha vendbanimet, përveç Delvinës, lejohet (a) ndërtimi i magazinave bujqësore, me kusht që ato të jenë pjesë e banesës dhe jo objekt i veçantë brenda tokës bujqësore dhe (b) instalimi I objekteve të industrisë të lehtë të kushtëzuara, nëse kanë të bëjnë me përpunimin dhe standardizimin e produkteve bujqësore.

   - Në nën-zonën M1-Monument Kulture lejohen përdorime të tjera të tokës (fillestare ose të tjera) sipas kushteve të përcaktuara nga autoriteti kompetent (DRTK Vlorë), në përputhje me Ligjin Nr. 27/2018, datë 17.05.2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", legjislacionin sektorial të zbatueshëm dhe duke iu shmangur kushteve të kësaj Rregulloreje.

   - Në zonat me kategorinë e përdorimit të tokës AS-Arsim, përveç nënkategorisë së lejuar çdo herë, lejojet edhe çdo objekt tjetër që i përket nënkategorive AS1 dhe AS2. Në çdo rast, komplekset shkollore do të funksionojnë si qendra komunitare me struktura sociale, kulturore dhe sportive, që i shërbejnë të gjithë banorëve.

4. Për zonat dhe njësitë në sistemin natyror, lejohet vendosja e parqeve fotovoltaike, me kusht që të poltësohen kushtet dhe standardet sipas legjislacionit përkatës.

5. Për zonat dhe njësitë në sistemin bujqësor, për kategoritë e përdorimit të tokës: B – Bujqësi, lejohet vendosja e parqeve fotovoltaike, me kusht që të poltësohen kushtet dhe standardet sipas legjislacionit përkatës.

KREU IV – Rregullat për çdo njësi

Seksioni I – Rregullat kryesore për çdo sistem territorial

Neni 23_Kriteret e përcaktimit të njësive strukturore

1. Njësia strukturore përbën qelizen më të vogël të planifikimit dhe qelizën më të madhe të zhvillimit në një territor. Çdo kërkesë për zhvillim bazohet në treguesit e planifikimit dhe kushtet e zhvillimit që vendosen në njësinë strukturore përkatëse.

2. Numri i Njësive Strukturore është 350, të cilat janë përcaktuar duke ju referuar këtyre kritereve:
   - Kufizimi nga rrjeti rrugor kryesor ekzistues dhe/ose i propozuar, dhe sipas rastit edhe nga kufizues të tjerë natyralë e artificialë, të cilët krijojnë elemente me karakter qartësisht te matshëm në territor, dhe sipas rastit përfshijnë vija ujore, lumenj, kanale të hapura, breza sanitarë, dhe të tjera të kësaj natyre;
   - Ekzistenca e një ekuilibri midis përdorimeve dhe funksioneve brenda çdo njësie strukturore, që përcaktohet përmes treguesve të planifikimit dhe të zhvillimit të cilët garantohen në çdo njësi përbërëse të njësisë strukturore;
   - Ekzistenca e funksioneve urbane që plotësojnë njeri-tjetrin dhe nevojat e popullatës urbane;
   - Bashkëkzistenca e përdorimeve të tokës dhe të strukturave në një njësi strukturore që janë të përputhshme dhe nuk paraqesin raste të përdorimeve të ndaluara, ose sipas rastit ekzistenca e përdorimit homogjen të tokës dhe strukturave në të, në të gjithë njësinë;
   - Garantimin e kompaktësisë dhe njëtrajtshmërisë së tipologjise hapësinore ekzistuese ose të propozuar;
   - Ekzistencën e treguesve të njëtrajtshëm të planifikimit dhe të zhvillimit;
   - Ekzistencën e përdorimit homogjen të tokës dhe të strukturave në të;
   - Kufizimin nga rrjeti rrugor, pavaresisht nga kategoritë e rrugëve, kanale të hapura, breza sanitarë, vija ujore, lumenj, dhe të tjera të kësaj natyre.

Neni 24_Planet e Detajuara Vendore

1. Zonat dhe njësitë strukturore të cilat do ti nënshtrohen hartimit të PDV-ve janë të përcaktuara në vijim të kësaj rregulloreje.

2. Tipologjitë kryesore të zonave të projektuara për PDV janë:
   - Zonat e zgjerimeve rezidenciale me sipërfaqe më shumë se 5 ha, Nënkategoritë A1;
   - Zonat e propozuara të aktiviteteve të organizuara ekonomike me sipërfaqe më shumë se 5 ha ose me ndikim të mesëm ambjental. Nënkategoritë IE1;
   - Zonat me prioritet zhvillimi, të projektuara nëpërmjet zonimeve të PPV për rizhvillim, ristrukturim ose rikonceptim;
   - Zonat e ndërtimeve informale.

3. Kjo rregullore përcakton njësitë strukturore ku mund të proçedohet me leje zhvillimi të cilat nuk do të jenë subjekt i PDV, sipas përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe akteve ligjore në fuqi.

4. Tipologjitë kryesore të zonave, ku nuk ka detyrim për hartim të PDV janë:
   - Zonat ekzistuese urbane të qyteteve (të periudhës së pas luftës), ku është zbatuar më parë një plan rregullator dhe ku ekziston një rrjet rrugësh dhe vija e ndërtimit. Nënkategoritë A1, A2, S1, S2.
   - Qendrat ekzistuese të vendbanimeve rurale (të periudhës së pas luftës), duke përfshirë zgjerimet e vogla deri në 25% e që nuk ndodhen në zonën bregdetare, duke ju referuar kryesisht vendbanimeve primare të popullsisë lokale. Nënkategoritë A1, A2.
   - Zona për përdorim publik, për përdorime të vecanta dhe infrastrukturë. Kategoritë IS, AS, SH, M, V, INT, IMB.

5. Rastet e punimeve në të cilat hartimi i PDV-së nuk është i detyrueshëm dhe/ose i nevojshëm brenda një njësie strukturore, edhe pse PPV-ja përcakton së njësia strukturore apo zona do të zhvillohet me PDV, janë:
   a. Për punime në infrastrukturë, të cilat nuk ndryshojnë treguesit e zhvillimit të njësisë stukturore të PPV-së;
   b. Për punime që kanë si pasojë prishjen e objekteve, në rast se prishja nuk shoqërohet me ndërtim të ri, përveç rasteve të parashikuara në këtë vendim;
   c. Për ndërtime të përkohshme;
   d. Për punime që realizojnë mirëmbajtje të jashtëzakonshme të objektit;
   e. Për punime si pasojë e emergjencave civile.
   f. Për punime që përmirësojnë elementët e aksesit në objekte e struktura, për personat me aftësi të kufizuara.
   g. Kur kërkohet miratimi i projekteve për objekte dhe infrastrukturë publike, në respektim të parashikimeve të PPV-së. Treguesit e zhvillimit, të dhënë për njësinë strukturore, do të jenë kufizues për pronat subjekt i këtij rasti përjashtimor.
   h. Kur kërkohet të kryhen punime për ndërhyrje që, sipas legjislacionit në fuqi, nuk kërkojnë pajisje me leje zhvillimi/ ndërtimi, ose realizohen përmes deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve.
   i. Kur kërkohet rikonstruksion, riparim ose restaurim i një objekti ekzistues, për sa kohë këto punime nuk ndryshojnë treguesit e zhvillimit të objektit ekzistues.
   j. Kur kërkohet rindërtimi i një banese të degraduar për ta kthyer atë në kushte të përshtatshme jetese, duke realizuar treguesit si KSHT, lartësia në kate dhe në metra (m), intensiteti i ndërtimit dhe distancat nga kufiri i pronës e objektet fqinjë, me vlera më të ulëta apo me të njëjtën vlerë si në gjendjen ekzistuese, apo sipas legjislacionit në fuqi.
   k. Kur kërkohet rikonstruksioni i një banese ekzistuese me shtesë vëllimi, anësore apo në lartësi për qëllime që lidhen me banimin, për sa kohë objekti i rikonstruktuar nuk tejkalon treguesit e zhvillimit të njësisë strukturore të PPV-së. Në çdo rast, shtesa në lartësi nuk duhet të jetë më shumë se 1 kat dhe objekti të mos kalojë lartësinë 3 kat.
   l. Kur kërkohet zhvillimi i një banese një-familjare, e cila plotëson kushtet si më poshtë:

a. Zhvillimi i tokës për banim me struktura një-familjare, është përdorim i lejuar nga PPV-ja në njësinë strukturore ku kërkohet zhvillimi.
b. Lartësia maksimale e kërkesës për zhvillim është 2 kat, 8m, ndërsa sipërfaqja totale e ndërtimit mbi tokë është jo më shumë se 250 m^2.
c. Me përjashtim të tre kushteve të zhvillimit të përcaktuara në gërmën b, kërkesa për zhvillim duhet të respektojë treguesit e tjerë të zhvillimit, sipas atyre të lejuara për njësinë strukturore të PPV-së.
d. Në rast se, treguesit e zhvillimit të njësisë për lartësinë e objektit dhe sipërfaqen totale të ndërtimit, janë më të vogla se ato të përcaktuara në gërmën b, më sipër, atëherë prevalojnë dhe zbatohen treguesit e zhvillimit të njësisë strukturore.

6. Në të gjitha rastet e pikës 5, përveç ndërhyrjeve që nuk kërkojnë leje ndërtimi, Bashkia njofton pronarin, aplikuesin për leje dhe personin përgjegjës për kryerjen e punimeve se sipas PPV-së zona do të zhvillohet me PDV. Pronari dhe/apo aplikuesi për leje marrin përgjegjësinë e kryerjes së punimeve, në kushtet në të cilat nuk është e ditur se në cilin moment kohor do të hartohet PDV-ja dhe se si mund të ndikojë ajo në ndërtimin/pronën përkatës/e.
7. Rastet përjashtimore janë të aplikueshme vetëm në territore që nuk janë pjesë e Brezit të Zhvillimit të Kontrolluar e Zona me Përparësi Zhvillimin e Turizmit.

Neni 25_Rregullat për sistemet e territorit

1. Në objektet dhe elementet e sistemit urban dhe infrastrukturor zbatohen rregullat e legjislacionit për planifikimin dhe të sektorëve të tjerë.

2. Në objektet dhe elementet e sistemit bujqësor zbatohen rregullat e legjislacionit në fuqi për tokën bujqësore.

3. Në objektet dhe elementet e sistemit natyror dhe të ujërave zbatohen rregullat e legjislacionit në fuqi për pyjet, kullotat, zonat e mbrojtura, biodiversitetin, burimet ujore, dhe mjedisin në tërësi.

4. Për të kaluar një territor nga sistemi bujqësor në sisteme të tjera, zbatohet legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe për ndryshimin e kategorisë së resursit të tokës.

5. Për të kaluar një territor nga sistemi natyror në sisteme të tjera, zbatohet legjislacioni për pyjet e kullotat dhe për ndryshimin e kategorisë së resursit të tokës.

6. Nëse parcela e ndërtimit ndahet në dy njësi strukturore atëherë llogaritjet e parametrave të zhvillimit bëhën në për secilën pjesë të parcelës dhe më pas mblidhen për tu zbatuar në një objekt të vetëm. Vetëm në rastin e lartësisë dhe numrit të kateve merret parasysh numri dhe lartësia e kateve e njërës nga dy njësitë strukturore e cila e ka më të lartë këtë parametër.

Neni 26_Rregullat për zhvillime në toka bujqësore dhe natyrore

1. Në rastet e ndërtimeve ekzistuese të veçuara me përdorime banim e shërbime në hapësira bujqësore apo natyrore dhe që përdorimet e propozuara janë tokë bujqësore apo tokë natyrore, nuk lejohen ndërtime të reja përveç ndërtimeve në funksion të bujqësisë dhe tokave natyrore sipas përcaktimeve ligjore përkatëse. Nga kjo rregullore përsa i përket ndërtimeve ekzistuese laejohet ndërtimi i një kati shtesë dhe duke u rritur me maksimumi 50% në gjurmën e ndërtimit.

2. Në Sistemin Bujqësor dhe Natyror lejohen zhvillime/ndërtime, të cilat lidhen pazgjidhshmërisht me resurset që ndodhen në këto sisteme/territore. Kusht paraprak është pajisja me leje të posaçme nga autoritetet kompetente dhe leja mjedisore.

3. Në njësitë që i përkasin sistemeve Urban (UB), Bujqësor (B), Natyror (N), autoritetet vendore të zhvillimit të territorit lejohet të japin leje zhvillimi/ndërtimi, për objektet e strukturat si më poshtë:

   a) Objekte për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, sipas legjislacionit të posaçëm sektorial;
   b) Struktura ku ushtrohet veprimtaria e agroturizmit, sipas përkufizimeve të legjislacionit të posaçëm sektorial.

Neni 27_Treguesit dhe rregullat për zonat, njësitë strukturore në Sistemin Urban

1. Treguesit dhe rregullat për zonat e banimit jepen për njësi strukturore dhe/ose zona me prioritet zhvillimi, të gjitha me përdorim homogjen banimin ose me përqindjen më të lartë të përdorimit të tokës për banim, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje për përdorimin e tokës dhe të strutkurave në të për kategorinë Banim (A).

2. Për të planifikuar dhe projektuar zona banimi, në përputhje me përcaktimin e kësaj rregulloreje për kategorinë bazë Banim, përcaktohen norma minimale sipas përcaktimeve të Seksionit III të këtij Kreu.

Neni 28_Treguesit dhe rregullat për zonat, njësitë strukturore në Sistemin Infrastrukturë

1. Madhësia e zonave me përdorim të kategorisë bazë industri varet nga lloji i industrisë, strukturat dhe territoret që nevojiten për të, si edhe nga rregullat dhe kushtet e përcaktuara në politikat e zhvillimit strategjik dhe të planifikimit territorial.

2. Zona industriale duhet të:
   - lidhet me të gjitha rrugët e trafikut të rëndë të jashtëm dhe të shpejtësisë së lartë;
   - respektojë distancat nga qendrat e banuara në varësi te llojit te aktivitetit dhe treguesve mjedisorë sipas përcaktimeve të legjislacionit të posaçëm në fuqi;
   - rrethohet me breza mbrojtes sanitare;

- pozicionohet në mënyrë të tillë që shkarkimet në ajër të mos lëvizin me erën drejt qytetit apo zonave të banuara dhe për këtë duhet te bazohet në trëndafilin e erërave;
- të ketë një rrjet të infrastrukturave të pavarur nga ai i zonës së banuar;
- të përmbajë edhe zonat dhe zgjidhjet e brendshme per trajtimin e mbetjeve të të gjitha llojeve që shkarkohen nga aktiviteti industrial;

3. Për ndërtimin dhe pozicionimin e impianteve të trajtimit dhe përpunimit të mbetjeve të ngurta sipas të gjitha kategorive të përbërjes së tyre, autoriteti i planifikimit i referohet dispozitave të legjislacionit të posaçëm për administrimin e mbetjeve.

Neni 29_Treguesit dhe rregullat për zonat, njësitë strukturore në Sistemin Natyror

1. Zhvillimi dhe ndërtimi në territoret e sistemit natyror kryhet vetëm në bazë të PPV, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 81/2017, "Për zonat e mbrojtura" dhe të VKM Nr. 102 datë 15.01.1996 "Për miratimin në parim të Strategjisë për Zbatimin e Projektit për Vlerësimin Mjedisor nga Zbatimi i Projektit të Pyjeve". Procesi i planifikimit dhe i zhvillimit në territore natyrore, si dhe ndryshimi i kategorisë përkatëse bazë të përdorimit të tokës në kategori të tjera rregullohet nga legjislacioni i posaçëm për pyjet dhe shërbimin pyjor, për tokën, për turizmin, për kullotat dhe livadhet, për menaxhimin e rezervave ujore dhe për mjedisin.

2. Propozimi për ndryshimin sipas pikës 1, të këtij neni, kryhet përmes dokumenteve të planifikimit dhe akteve përkatëse të detyrueshme nga legjislacioni i posaçëm.

3. Procesi i përgatitjes të aktit/akteve përkatëse sipas pikës 2, të këtij neni, kryhet paralelisht me hartimin e dokumentit të planifikimit dhe miratohet nga autoritetet përgjegjëse sipas legjislacionit të posaçëm.

4. Në zonën e Rezervatit Natyror të Menaxhuar të Rrëzomës, si zonë e mbrojtur e Kategorisë IV, janë te ndaluara:
   - ndryshimet e gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve ligatinore;
   - shfrytëzimi dhe zënia e zonës me aktivitete që bien ndesh me qëllimet për të cilat ajo është marrë në mbrojtje.

5. Në zonën e Rezervatit Natyror të Menaxhuar mund te ushtrohen, por vetëm pasi të pajisen me leje mjedisi nga autoritetet përkatëse, veprimtaritë që synojnë:
   - lëvizja dhe parkimi i automjeteve jashtë rrugëve publike dhe vendeve të caktuara për parkim;
   - mbledhja e bimëve, gjetjeve paleontologjike dhe e gurëve që nuk dëmtojnë habitatin natyror;
   - ngritja dhe funksionimi i objekteve për qëllime ushtarake dhe mbrojtjeje.
   - vendosja e stendave, tabelave të të dhënave, reklamave, shenjave dhe posterave, me përjashtim të atyre që japin të dhëna për objektivat e mbrojtjes së rezervatit;

- skitë, kampingjet dhe ndezja e zjarreve jashtë pikave të caktuara.

6. Zona buferike e Rezervatit Natyror të Menaxhuar është territori rreth parkut, me gjerësi rreth 50 m nga kufiri i tij.

Neni 30_Treguesit dhe rregullat për zonat, njësitë strukturore në Sistemin Bujqësor

1. Zhvillimi dhe ndërtimi në territoret e sistemit bujqësor kryhet vetëm në bazë të PPV, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9244, datë 16.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore" i ndryshuar, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës" i ndryshuar, Vendimit të Keshillit të Ministrave nr. Nr.410, datë 27.6.2012, "Për rregullat dhe proçedurat e ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës", e ndryshuar.

2. Në zonat që i përkasin kategorisë së përdorimit bujqësi, pavarësisht përzierjes së kategorive, dhe sipas tabelave të Shtojcës 2 të kësaj Rregulloreje, zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore për mbrojtjen e tokës dhe ndërtimin në tokë bujqësore. Në këto zona:
   - Ndërtimet për qëllime, apo në funksion të aktivitetit bujqësor e blegtoral, të cilat kryhen në tokë bujqësore, në të paktën një nga rastet e mëposhtme, do të përcaktohen si zhvillime me karakter tranzitor në tokë bujqësore dhe për këtë qëllim nuk do të ndryshojë kategoria e parcelës përkatëse të ndërtimit/zhvillimit nga bujqësore në urbane, në rastet kur zhvillimi I propozuar shtrihet:
     - në brendësi të tokës bujqësore dhe/ose larg rrugëve interurbane,
     - larg fshatrave, qendrave urbane ose qendrave të banuara në tërësi,
     - ose në zona të cilat nuk përcaktohen për ndryshim të kategorisë së sistemit bujqësor të cilit i përkasin në një tjetër sistem.

   Nëse Bashkia Delvinë duhet të ndërtojë rrugë shërbimi në tokë bujqësore me qëllim sigurimin e aksesit për aktivitete në funksion të bujqësisë dhe blegtorisë, apo zhvillimit ekonomik mbi bazën e bujqësisë dhe blegtorisë, atëherë ato do të projektohen mbi gjurmën e rrugës bujqësore ekzistuese, duke parashikuar në të dy krahët sistemin e kanaleve kulluese e ujitëse, sipas kategorive që lejohen në ligj. Rruga e shërbimit do të ketë 1-2 korsi pa trotuare. Korsitë planifikohen në vlerën e tyre minimale të gjerësisë sipas legjislacionit në fuqi për rrugët. Nuk lejohet ndërtimi i rrugës së shërbimit mbi tokë bujqësore.
   - Rrugët bujqësore të ndërtuara përgjatë kanaleve kulluese e vaditëse sipas kategorive përkatëse dhe legjislacionit në fuqi për infrastrukturën e kullimit dhe ujitjes, ruhen të pacënuara nga ndërtime dhe ndërhyrje të çdo lloji tjetër, përveç atyre rikonstruktuese, rehabilituese, ristrukturuese. Çdo aktivitet që cënon funksionin e rrugës bujqësore është i paligjshëm.
   - Në parcelat bujqësore që janë të përqëndruara në zonat BA, të cilat paraqesin nivel të lartë të fragmentimit të tokës bujqësore ku identifikohet prezenca e banesave familjare të shpërndara deri në 2 (dy) kat, mund të ndërtohet deri në 1 (një) kat shtesë në lartësi në banesën ekzistuese, ose të realizojë shtesë anësore deri në shfrytëzimin e plotë të parcelës së tij ndërtimore, të njohur si truall për ndërtim nga procedurat ligjore mbi tokën bujqësore. Në çdo rast, banesa nuk duhet të cënojë distancat e përcaktuara në legjislacion dhe në këtë Rregullore

për çdo objekt në tokë bujqësore. Ky rregull zbatohet edhe për ndërtesat e banimit, të cilat janë legalizuar ose kanë përfunduar vetëdeklarimin dhe janë në proces legalizimi në momentin e hyrjes në fuqi të Planit dhe të kësaj Rregulloreje. Në këtë pikë nuk përfshihen ndërtesat e pa deklaruara dhe të pa legalizuara, këto struktura duhet në çdo rast të ndërmarrin procesin e legjitimimit në zbatim të legjislacionit përkatës. Ky rregull nuk aplikohet ne zonat B, IB, EB.

Neni 31_ Zhvillimi i Agroturizmit dhe Ekoturizmit

1. Në njësitë që i përkasin sistemeve Urban, Bujqësor dhe Natyror lejohet zhvillimi i aktiviteteve agroturistike dhe ekoturistike, me kusht:
   - Respektimin e përcaktimeve ligjore në fuqi në fushën e bujqësisë, natyrës, mjedisit, pyjeve e kullotave, zonave të mbrojtura, etj. sipas territorit specifik;
   - Respektimin e përcaktimeve ligjore sektoriale në fushën e agroturizmit dhe ekoturizmit;
   - Bashkërendimin dhe marrjen e konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe zonave të rëndësisë kombëtare, sipas legjislacionit në fuqi;
   - Respektimin e kontekstit natyror/bujqësor dhe ruajtjen e peizazhit rural;
   - Sigurimin e pajisjes së strukturave të veprimtarisë agro/ekoturistike me infrastrukturat inxhinierike të nevojshme, sipas legjislacionit përkatës;
   - Moscënimin e infrastrukturës në funksion të tokës bujqësore (kanale kullues/vaditës, rrugë bujqësore, rezervuar, etj).

2. Nëse nuk përcaktohet ndryshe në pasaportën e njësisë strukturore përkatëse apo nga legjislacioni në fuqi, strukturat agroturistike nuk duhet të kalojnë lartësinë 2 kate me nënçati.

3. Riparimi, rinovimi, shtesat dhe përshtatja e strukturave ekzistuese të funksioneve të ndryshme në struktura në funksion të agroturizmit dhe ekoturizmit është e lejuar me përmbushjen e përcaktimeve të këtij neni dhe në çdo rast duke respektuar legjislacionin sektorial në fuqi. Strukturat ekzistuese mund të zgjerohen në respektim të pikës 2 të këtij neni.

4. Pas miratimit të kërkesave për zhvillim/ndërtim agroturizmi / ekoturizmi në këto territore duhet të njoftohen zyrtarisht Ministritë e Linjës për zhvillimet në fjalë.

5. Nuk lejohet ndryshimi i destinacionit të strukturave të agroturizmit dhe ekoturizmit në vijimësi

Seksioni II – Rregullat dhe kriteret për ndërtimin e objekteve për qëllime bujqësore

Neni 32_Tipologjitë e strukturave për prodhimin, ruajtjen, përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale që ndërtohen në tokë bujqësore

1. Në kuptimin e kësaj rreguloreje, përkufizimi dhe rregullat e zhvillimit të strukturave për prodhimin, ruajtjen, përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale që ndërtohen në tokë bujqësore, i referohen legjislacionit të posaçëm Ligjit nr.8752, datë 26.03.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave të adminisistrimit dhe mbrojtjes së tokës" të ndryshuar, dhe Vendimit të KM nr.283, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore", i ndryshuar, janë:
   - stallat për mbarështimin e kafshëve dhe objektet ndihmëse funksionale, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen në depo silazhi, hangar, silos, ambiente për përpunimin e ushqimeve, sallë mjeljeje, padoqe, plehrishte, depozita uji;
   - serrat me themele të vazhduara, të cilat janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën;
   - objektet ndihmëse funksionale të serrave, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen në magazina për standardizimin e prodhimit dhe mbajtjen e pajisjeve, imputeve;
   - objektet për tharjen dhe trajtimin paraprak të nevojshëm të produkteve në kultura, të tilla si bimët medicinale etj.;
   - objektet për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale, përfshirë dhe ato frigoriferike;
   - objekte për përpunimin e produkteve primare, bujqësore dhe blegtorale;
   - të tjera që mund të lejojë legjislacioni në fuqi;
   - thertoret.

2. Këto struktura planifikohen bazuar në analizat e përvitshme të sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë, duke marrë në konsideratë dhe nevojat e zonave specifike. Në çdo rast ndërtimi I këtyre strukturave do të kryhet në zbatim të legjislacionit në fuqi duke vlerësuar ndikimin në mjedis që sjell zhvillimi.

Neni 33_Rregulla dhe kritere për ndërtimin e objekteve për qëllime bujqësore

1. Lejet e ndërtimit për objektet e për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore, jepen sipas përcaktimeve të VKM Nr. 283, date 01.04.2015, në të cilën përcaktohet edhe tipologjia e këtyre objekteve.

2. Për të gjitha objektet për qëllime bujqësore duhet të respektohen distancat nga rrugët, hekurudhat, aeroportet, linjat e tensionit të lartë e çdo infrastrukure tjetër publike dhe distancat nga kanalet ujitëse e kulluese, si dhe brigjet e lumenjve, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

3. Lejet e ndërtimit për objektet me qëllime bujqësore jepen vetëm pasi të jetë verifikuar ekzistenca e infrastrukturave të nevojshme, për sa u përket rrugëve lidhëse, elektricitetit dhe ujit të pijshëm ose marrjes përsipër të realizimit të tyre nga investitori njëkohësisht me ndërtimin e objekteve të sipërpërmendura.

4. Leja e ndërtimit jepen vetëm me kushtin e ruajtjes dhe mosndryshimit të destinacionit për qëllim bujqësor/blegtoral të objektit për të cilin është lëshuar.

5. Për qëllim të llogaritjes së vëllimit/sipërfaqes së ndërtimit, në intensitetin e ndërtimit përfshihet ngastra ose bllok ngastrash edhe kur ndahen nga rrugë, kanale apo kufij të tjerë natyralë, në pronësi apo përdorim. Lëshimi i lejes së ndërtimit për objektet, sipas kësaj pike, shteron mundësinë e ndërtimit në të gjitha ngastrat që janë përdorur për llogaritjen e vëllimit/sipërfaqes së ndërtimit. Ndërtimet e lejuara në tokë bujqësore nuk duhet në asnjë rast të cenojnë infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit të tokës bujqësore.

6. Ndërtimet e objekteve ndihmëse funksionale për tipat e objekteve bujqësore, i referohen gjithmonë intensitetit të ndërtimit për qëllime bujqësore dhe duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
   - vëllimi maksimal i objektit të mos tejkalojë intensitetin ib 0.03 m^3/m^2;
   - të zhvillohen në një kat të vetëm dhe të respektojnë lartësinë maksimale 4,50 metër, me përjashtim të oxhakëve, siloseve dhe strukturave që tejkalojnë këtë lartësi për shkak të karakteristikave teknike;
   - të respektohet distanca minimale 5 metër nga kufijtë e pronës;
   - të realizohen sipas tipologjive të përshtatshme për funksionin që do të kryejnë dhe që nuk lejojnë ndryshimin e destinacionit të përdorimit.

7. Ndërtimet e reja të stallave lejohen me kusht që të garantojnë menaxhimin e jashtëqitjeve shtazore, me filtrim paraprak.

8. Stallat, që mbarështojnë mbi 50 njësi gjedhi mbi bazë ditore, duhet të kenë këto karakteristika:
   a) të respektojnë distancat minimale të mëposhtme:
      - 20 metër nga kufijtë e pronës;
      - 500 metër nga qendrat e banuara;
      - 100 metër nga banesa më e afërt, e veçuar nga qendra urbane.
   b) të zhvillohen në një kat të vetëm, me lartësi të ndryshme në bazë të karakteristikave të veçanta teknike dhe lartësi maksimale 4,50 m;
   c) vëllimi maksimal i objektit të mos tejkalojë intensitetin ib 0.5 m^3/m^2.

9. Për stallat që mbarështojnë 10-50 njësi gjedhi mbi bazë ditore, distancat minimale nga kufijtë e pronës janë 10 metër, ndërsa karakteristikat e tjera janë të njëjta me ato të përcaktuara në pikën 3.

10. Për stallat që mbarështojnë 5-10 njësi gjedhi mbi bazë ditore, distancat minimale nga kufijtë e pronës janë 5 metër, ndërsa nga banesa më e afërt 50 metër. Karakteristikat e tjera janë të njëjta me ato të përcaktuara në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 3, të këtij neni.

11. Strukturat për grumbullimin e jashtëqitjeve me origjinë shtazore duhet të vendosen në distancë jo më të vogël se 50 metër nga banesat për stallat me 5-10 njësi gjedhi dhe 100 metër për stallat më të mëdha.

12. Sipërfaqja e serrave me themele të vazhduara, të cilat janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën, nuk duhet të tejkalojë 70% të sipërfaqes së pronës.

13. Për serrat e përcaktuara në pikën 7 duhet të respektohen distancat e mëposhtme:
    a. jo më pak se 5 metër nga banesat ekzistuese në të njëjtën ngastër dhe 10 metër nga banesat e tjera;
    b. jo më pak se 3 m nga kufiri i pronës

14. Për serrat e tipave të tjera, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën, nuk kërkohet pajisja me një leje ndërtimi dhe ato janë objekt i një deklarate paraprake për kryerje punimesh. Distancat për ndërtimin e tyre janë të njëjta me ato të përcaktuara në pikën 8 të këtij neni.

15. Ndërtimet e objekteve për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, përfshirë dhe ato për tharjen e trajtimin paraprak të produkteve bujqësore, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
    a. vëllimi maksimal i objektit të mos tejkalojë intensitetin ib 1 m^3/m^2;
    b. të respektojnë distancat minimale 7 metër nga kufijtë e pronës dhe 10 m nga ndërtesa të tjera.

16. Ndërtimet e objekteve për thertore duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
    a. vëllimi maksimal i objektit të mos tejkalojë intensitetin ib 1 m^3/m^2;
    b. të respektojnë distancat minimale të mëposhtme:
        - 20 metër nga kufijtë e pronës
        - 500 metër nga qendrat e banuara;
        - 100 metër nga banesa më e afërt, e veçuar nga qendra urbane.

17. Ndërtimet e objekteve ndihmëse funksionale janë të lejuara vetëm në zonat EB1, EB2 dhe EB3.

18. Rregullat dhe kriteret e përcaktuara në të gjitha pikat e këtij neni zbatohen në të gjitha rastet, përveçse kur me akte të tjera, ligjore e nënligjore, përcaktohet ndryshe.

Seksioni III – Normat e planifikimit dhe zhvillimit në zonat e banimit

Neni 34_Rregullat në planifikim territori dhe projektim urban

1. Rregullat, kushtet dhe normat gjatë planifikimit të territorit dhe projektimit urban, janë të detyrueshme për t`u zbatuar nga specialistët, ekspertet, entet dhe subjektet e planifikimit dhe projektimit urban, për çdo instrument planifikimi dhe zhvillimi të hartuar në territorin e Bashkisë Delvinë.

2. Vlerësimi dhe miratimi i instrumenteve të planifikimit, të PDV dhe të projekteve kryhet, mbi bazën e rregullave, kushteve dhe normave të planifikimit të territorit dhe të projektimit urban, pa rënë ndesh me sa parashikon legjislacioni në fuqi, duke zbatuar këto tregues qoftë në nivel zone, njësie, qoftë në nivel parcele.

3. Rregullat, kushtet dhe normat ndryshojne sipas karakterit ekzistues dhe të propozuar të zones që studiohet, në lidhje me përdorimin e tokës, tipet e strukturave, tipologjitë hapesinore, funksionet, aktivitetet, dhe me kushte specifike të vendosura nga dispozitat ligjore dhe politikat sektoriale në fuqi dhe së bashku në një proçes planifikimit dhe/ose projektimi. Një planifikues apo projektues, duhet të vlerësojë këto rregulla, kushte dhe norma, para se të japë zgjidhjen përfundimtare, si dhe duhet t`i referojë ato në instrumentin e hartuar.

Neni 35_Sipërfaqe e ndërtueshme e parcelës

1. Sipërfaqja e ndërtueshme e parcelës llogaritet si diferencë e sipërfaqes totale të parcelës me sipërfaqen që nevojitet për infrastruktura publike.

Neni 36_Sipërfaqe totale ndërtimi

1. Sipërfaqe totale e ndërtimit është llogaritur për çdo njësi strukturore si produkt I sipërfaqes së ndërtueshme të zonës më intensitetin maksimal të lejuar të ndërtimit të njësisë.

Neni 37_Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit për zonën

1. Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit për çdo njësi strukturore, është I barabartë me raportin e sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit të kateve mbi tokë për të gjithë njësinë me shumën e sipërfaqeve të parcelave të ndërtueshme në të. Në llogaritjen e Intensitetin për njësinë nuk përfshihen rrugët (KSHR) dhe hapësirat publike (KSHP). Intensiteti i ndërtimit në bashkinë e Delvinës, për objektet e banimit nuk duhet të kalojë vlerën 2.2.

2. Në rast se ndërtimi zhvillohet në një territor të pjerrët ku diferenca e lartësisë është një kat midis dy faqeve të kundërta të ndërtesës për shkak të pjerrësisë së terrenit, dhe kur kjo hapësirë përdoret si garazh I hapur në të paktën 70% të sipërfaqes së katit përdhe, kjo sipërfaqe ndërtimi nuk do të konsiderohet kat, dhe nuk do të përfshihet në llogaritjen e sipërfaqes totale të ndërtimit për banim, si dhe në llogaritjen e intesitetit të ndërtimit.

Neni 38_Koeficienti maksimal i shfrytëzimit të tokës për ndërtime

1. Raporti i shfrytëzimit të parcelës. Siperfaqe e shprehur në m2 që një strukturë ze në një parcelë ndertimi. Hapësira gjysëm të mbuluara që janë përfshirë në elementet e

strukturës së ndërtesës (sic janë taracat e mbuluara) përfshihen brenda siperfaqes së zënë të parcelës. Pjesë të ballkoneve dhe elementeve arkitektonike që dalin jashtë volumit të ndërtimit dhe konstruksione të lehta (tenda të ndryshme) nuk janë matur brenda siperfaqes së zënë të parcelës. Koeficienti maksimal I shfrytëzimit të tokës në bashkinë e Delvinës, për objektet e banimit nuk duhet të kalojë vlerën 50%.

Neni 39_Koeficienti minimal i shfrytëzimit të tokës për rrugë

1. Koeficienti minimal i shfrytëzimit të tokës për rrugë është gjithmonë 10% e sipërfaqes totale të zonës.

Neni 40_Koeficienti i shfrytëzimit të tokës për hapësira publike

1. Koeficienti i shfrytëzimit të tokës për hapësira publike është minimalisht 20% e sipërfaqes totale të zonës.

Neni 41_Sipërfaqe gjelbërim publik në zone

1. Sipërfaqe gjelbërim publik në zonë llogaritet si produkt i numrit të popullsisë së pritshme banuese me normativen e nevojshme sipërfaqe gjelbërimi për banor në nivel njësie 2.5m²/banor.

Neni 42_Lartësia maksimale e lejuar e ndërtesave

1. (Në metra dhe numër katesh). Lartësia maksimale e ndërtimit e shprehur në kate, është numri maksimal i lejuar i kateve mbi siperfaqen e tokës, madje edhe pjesërisht mbi tokë, duke përfshirë edhe katin nën çati, ose gjysmëkatin.
   Lartësia maksimale e ndërtimit përfshin:
   - lartësinë tip te katit (dysheme-dysheme) = 3.m
   - lartësinë e katit përdhes = 3m deri në 5m (në vartësi të përdorimit të tokës, sic specifikohet në "kodin e zonimit).

2. Lartësia minimale e katit, e matur në brendësi të ndërtesës (distanca vertikale në mes të nivelit të dyshemesë dhe tavanit), nuk mund të jetë më pak se 2.7 meter.

3. Kati nëntokë, që sipas rastit mund të jetë emërtuar edhe "Bodrum", është vëllimi I ndërtimit të katit të objektit, i cili vendoset tërësisht ose kryesisht nëntokë, me kusht që kuota e sipërme e tij e matur në dyshemenë e përfunduar të katit mbi katin nëntokë, të mos jetë më shumë se 1 metër mbi nivelin e kuotës së sistemuar të trotuarit ose sheshit rrethues të jashtëm të strukturës.

4. Në ndërtimet me çati, hapësira nën çati vlerësohet si një kat kur, pjerrësia e saj lejon shfrytëzimin e të paktën 50% të sipërfaqes së përgjithshme të banimit të katit që mbulohet. Kur shfrytëzimi i hapësirës nën çati është të paktën 30% dhe më pak se 50%, kjo hapësirë vlerësohet si gjysmë kati.

5. Strukturat mbi tarracë e çati, si: oxhaqet, tubat, kafazi I shkallëve, ambjente ndihmëse, pajisjet e ashensorëve, panele diellore, parapet dhe elemente të tjera të ngjashme, nuk llogariten në lartësinë e strukturave.

6. Për të gjitha strukturat me çati, lartësia maksimale e strukturës e shprehur në metra do të matet në lartësinë maksimale të mureve perimetrale të strukturës, ndërsa lartësia maksimale e shprehur në kate do të matet sipas numrit të sipërfaqeve të shfrytëzueshme për banim.

Neni 43_Kerkesat e parkimit

1. Kërkesat për parashikim parkimi në ndërtimet e reja, përveç rasteve kur shënohet ndryshe, kërkesat e parkimit janë:
   - për përdoruesit rezidencial: hapësira parkimi për 100-250m2 të sipërfaqes së katit;
   - për restorante /bare dhe përdoruesit shlodhës: 1 hapësirë parkimi për 40-80m2 të sipërfaqes së ndvrtuar të katit;
   - për sherbimet kulturore dhe tregtare 1 hapësire parkimi për 50-100m2 të sipërfaqes së ndërtuar të katit;
   - për hotelet dhe resortet: 1 hapësirë parkimi për 10-15 dhoma.
2. Numri minimal i vendparkimeve publike llogaritet bazuar në normativën 1 vendparkim për 2 banor. Ndërsa për parkimin privat për struktura banimi, pavarësisht formës së tij, llogartitet 1 vendparkim për apartament.

Neni 44_Treguesit e zhvillimit në zonat që nuk janë subjekt i Planeve të Detajuara Vendore

1. Për zhvillimin e zonave me kategori bazë Banim që nuk janë subjekt i planeve të detajuara vendore, konsiderohet:
   - si intensitet maksimal i lejuar, për parcelën, ai i përcaktuar për Njësinë Strukturore në të cilën shtrihet parcela;
   - si koeficient maksimal i shfrytëzimit të tokës për ndërtime, për parcelën, ai I lejuar për Njësinë Strukturore në të cilën shtrihet parcela;
   - si koeficient minimal i shfrytëzimit të tokës për rrugë, për parcelën, ai I lejuar për Njësinë Strukturore në të cilën shtrihet parcela;
   - si koeficient minimal i shfrytëzimit të tokës për hapësira publike, për parcelën, ai i lejuar për Njësinë Strukturore në të cilën shtrihet parcela;
   - si lartësi maksimale e lejuar për ndërtesat që do të ndërtohen në parcelelë, ajo e lejuar për Njësinë Strukturore në të cilën shtrihet parcela;
   - për territoret në të cilët tipologjia e ndërhyrjes do të jetë konsolidimi, në çdo rast do të respektohen treguesit e përcaktuar për Njësinë strukturore përkatëse, por duke ruajtur tipologjinë e strukturave që mbizotërojnë në zonë referuar nenit 19 të kësaj Rregulloreje.

Neni 45_Treguesit e distancave

1. Treguesit bazë të përcaktuar nga kjo rregullore janë të detyrueshëm për t'u zbatuar projektuesit gjatë hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit.

2. Distancat sipas këtij neni duhet të jenë të tilla që të mos cenojnë lirinë e përdorimit të pronës, të krijojnë hapësira publike dhe/ose funksionale të nevojshme për shërbimet ndaj komunitetit dhe të garantojnë siguri individuale dhe shëndetësore.

3. Distancat mes zonave të shërbimit përgjatë rrugëve përcaktohen sipas Nenit 62/1 të Rregullores "Rregullat teknike të vendosjes së zonave të shërbimit në rrugë", në zbatim të Kodit Rrugor, miratuar me VKM Nr. 153 datë 07.04.2000 "Për miratimin e Rregullores në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë".

4. Distancat e përcaktuara në këtë rregullore janë:
   - distancat midis ndërtimeve;
   - distancat midis ndërtimit dhe kufirit të parcelës/pronës;
   - distancat midis ndërtimit dhe kufirit të trupit të rrugës;

5. Përcaktimi i distancave bëhet nga autoriteti i planifikimit sipas përcaktimeve në këtë rregullore dhe në PDV, në përputhje me këtë nen, për sa kohë që nuk parashikohet ndryshe në legjislacionin e posaçëm sektorial në fuqi.

6. Për përcaktimin e distancave vlerësohen: orientimi dhe diellzimi, gjendja e ndërtimeve kufitare, tandardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe të sigurisë sipas legjislacionit të posaçëm.

7. Orientimi bëhet drejt jugut në kufijtë deri 40 gradë të tij, sipas rastit duke preferuar drejtimin gjatësor të strukturës përkundrejt orientimit, si dhe garantimi i minimumi 3 orë diell në periudhën 22 shtator - 22 mars, për objektin.

8. Për përcaktimin e distancave ndertese-ndërtesë, ndertese-rrugë dhe ndertese-kufij prone, në projektim, do të zbatohen normat minimale të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, VKM nr. 408 datë 13.05.2015 Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit, e ndryshuar, me përjashtim të rasteve kur PDV propozon distanca të tjera më ta mëdha se minimumi i parashikuar.

9. Në zonat e konservimit, që nuk janë subjekt për hartimin e PDV-ve, në rastet e nevojës së rindërtimit të banesave të vjetra dhe të papërshtatshme për të jetuar në parcelën ekzistuese, do të ruhen distancat e ndërtesës ekzistuese edhe për ndërtimin e ri, me kusht që të mos ndryshojnë koeficienti i shfrytëzimit të truallit dhe intensiteti i ndërtimit ekzistues.

10. Vija e ndërtimit përcaktohet nëpërmjet rregullave të distancave të objekteve nga kufiri i pronës dhe nga rruga në njësitë strukturore dhe zonat me prioritet zhvillimi. Për sa nuk parashikohet ndryshe në këtë rregullore, vija e ndërtimit respekton:
    - Distancat e ndërtimeve nga kufiri i pronës sipas rregullores së zhvillimit të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave;
    - Distancat e ndërtimeve nga rruga sipas rregullores së zhvillimit të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave;

11. Distanca minimale e lejuar midis dy ndërtimeve do të matet me shumën e numrit të kateve mbi tokë të ndërtimeve që përballen plus 2m, sipas formulës më poshtë: d = nr. k obj. A + nr. k obj. B +2m, ku: d - distanca minimale midis dy ndërtimeve. nr. k - numri i kateve.

12. Distanca minimale e lejuar e ndërtimit nga kufiri i pronës përcaktohet si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m (d= nr. k +1m) ku: d - distanca minimale e ndërtimit nga kufiri i pronës dhe nr. k - numri i kateve.

13. Distanca e pikave të furnizimit të karburantit në zonë urbane përcaktohet sipas Kodit Rrugor miratuar me VKM Nr. 153 datë 07.04.2000 (neni 62/1) "Për miratimin e Rregullores në zbatim të Kodit Rrugor".

14. Në rastet kur përdoret gropë septike dhe pus individual për furnizimin me ujë në zonat e banimit rurale distanca mes të dyve është të paktën 15m.

15. Në rast se një ndërtesë ekzistuese (NE) ka respektuar të gjitha kushtet e distancave (ndërtesë-ndërtesë, ndërtesë-kufi prone, ndërtesë-rrugë), ndërsa ndërtimi fqinjë (NF) nuk respekton të paktën një prej tyre, atëherë pronarit të NE-së i lind e drejta të ndërtojë objekt të ri ose shtojë kat/e në lartësi apo anësor/e, për sa kohë që vendosja e NE-së dhe e shtesës nuk bien në kundërshtim me rregullat e parcelës për distancat ndërtesë-kufi prone dhe ndërtesë-rrugë. Distanca ndërtesë-ndërtesë nuk është objekt vlerësimi për ndërtimin e ri që kërkon NE-ja, në rast se NF-ja ka shkelur rregullin e distancës nga kufiri i pronës përkatëse dhe/ose nga rruga sipas legjislacionit në momentin e dhënies së lejes apo legalizimit të saj.

16. Për arsye të zhvillimit të parashikuar nga PPV-ja për një zonë urbane të konsoliduar ose për rizhvillim/ripërtëritje, veçanërisht në kushtet e zbatimit të instrumenteve financiare të drejtimit të zhvillimit, apo kur diktohet nga nevoja për krijim të hapësirës publike në një zonë urbane me zhvillim intensiv, distanca e objektit/ndërtesës nga trupi i rruges do të përcaktohet PDV ose nga Plani rrugor, I cili do të përcaktojë dhe vijën e ndërtimit.

17. Nëse PPV-ja përcakton për një zonë se është objekt i PDV-së dhe zona ka ndërtesa ekzistuese të cilat nuk do të prishen, propozuesi i PDV-së (pala aplikuese) dhe Bashkia vendosin pa rënë në kundërshtim me sa parashikohet në këtë rregullore, sipas dy rasteve të mëposhtme:

   - T`i përfshijnë ndërtesat ekzistuese në skemën e menaxhimit të pronave sipas PDV-së e, për rrjedhojë, edhe në marrëveshjen e PDV-së. Në këtë rast, skema e konsolidimit të pronësisë tokë ose, ndryshe, bashkimi i parcelave zbatohet edhe për objektet ekzistuese. E gjithë zona e trajtuar në PDV do të përbëjë një pronësi të vetme sipas së cilës në marrëveshjen e PDV-së do të ndahen kostot dhe përfitimet për palët pjesëmarrëse. Distancat ndërtesë-ndërtesë dhe ndërtesë-rrugë janë të vetmet që aplikohen brenda zonës së PDV-së, për sa kohë që trualli mbetet një i vetëm dhe i barabartë me zonën e PDV-së. Në

rast të krijimit të dy ose më tepër pronësive troje brenda zonës së PDV-së, atëherë aplikohen edhe distancat ndërtesë - kufi prone.

- Të mos i përfshijnë ndërtesat ekzistuese në skemën e manaxhimit të pronave sipas PDV-së e, për rrjedhojë, as në marrëveshjen e PDV-së. Në këtë rast i gjithë zhvillimi i propozuar nga PDV-ja duhet të respektojë distancat me objektet ekzistuese për të trija kategoritë: ndërtesë-ndërtesë, ndërtesë-rrugë dhe ndërtesë - kufi prone. Mospërfshirja e këtyre ndërtesave/pronave në marrëveshjen e PDV-së kryhet me vullnetin e pronarëve te tyre, mbi bazën e procesit të PDV-së sipas ligjit nr10/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar.

Neni 46_ Vija e Gjelbër, Vija e Kuqe, Vija Blu

1. Vija e ndërtimit ose vija e gjelbër sipas kuadrit ligjor në fuqi, është kufiri maksimal I lejuar për vendosjen e një strukture në lidhje me trupin e rrugës ose kufirin e zones zhvillimore apo njësisë që i referohet, referuar kushteve ligjore të përcaktuara në Kodin Rrugor apo vijave të ndërtimit ekzistuese të përcaktuara nga situata e formuar në terren apo analiza mbi terrenin nga studimi i rrjetit rrugor apo planet e detajuara vendore.

2. Vija e ndërtimit përcakton pozicionimin e faqes të një strukture në raport me kufirin e trupit të rrugës ekzistuese apo të propozuar.

3. Faqe e strukturës nënkupton trupin e përgjithshëm të strukturës, çdo dalje konsol do të quhet faqe ndërtimi dhe duhet të respektojë distancat nga trupi i rrugës. Nuk kërkohet të respektojnë distancat elementet arkitektonikë të fasadave, të cilat nuk përbëjnë sipërfaqe të shfrytëzueshme dhe nuk dalin nga fasada më shumë se 0.5 metër.

4. Nuk lejohet që konsolat të tejkalojnë vijën e ndërtimit në lartësi më të ulët se 5 metra nga kuota e trotuarit dhe 1.6 metra nga faqja e strukturës.

5. Në rastet kur planet e sistemimit dhe të vendosjes të katit përdhe parashikojnë nevojën e vendosjes së shkallëve dhe rampave për akses, nuk lejohet që pozicionimi I tyre të tejkalojë vijën e ndërtimit.

6. Nga rregullat e pikave 2, 3 dhe 4 të këtij neni bëjnë përjashtim rastet e tipologjive të strukturave me arkitekturë të theksuar volumetrike.

7. Në çdo rast, volumetria e strukturës duhet të jetë brënda kufijve të parcelës apo grup parcelave të pronave të përfshira në zhvillim.

8. Tërheqja e vijës së ndërtimit (vija e kuqe) nga vija e rrugës, përcaktohet në varësi të kategorisë të zonimit dhe kategorive të rrugës. Në çdo rast, me përjashtim të rrugëve me korsi parkimi – rrugë bulevarde, rekomandohet një tërheqje minimale e vijës së ndërtimit nga vija e rrugës për të krijuar breza të gjelbëruar.

9. Vija e ndërtimit merr në konsideratë udhëzimet e VKM nr. 153, datë 07.04.2000 "Për miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", si kusht realizimi i brezave të sigurisë, si dhe përcaktohet për të arritur një tipologji të caktuar urbane në rrugët lokale F.

10. Në akset e klasifikuar si rrugë të kategorisë C, tërheqja minimale, për të formuar vijën e ndërtimit, është 10 metra.

11. Tërheqja minimale, për të formuar vijën e ndërtimit, në rrugët e tjera përcaktohet me PDV, në rastet kur PDV-ja është kusht, në të kundërt aplikohet një tërheqje prej 3 metrash, për rrugët urbane brenda qendrave të banuara dhe 5 metra për rrugët urbane jashtë qendrave të banuara.

12. Në përcaktimin e vijave të ndërtimit nëse nuk është përcaktuar në rregullore apo harta, prioritet kanë brezat mbrojtës, që derivojnë nga legjislacioni në fuqi, në rastin kur parashikojnë distanca më të mëdha, mbi rregullat e njësive të planit.

13. Hapësira e krijuar si pasojë e diferencës vijë rruge - vijë ndërtimi:
a) Në rastin e banesave individuale është pjesë e oborrit privat, me gjelbërim, shtrim, hapësirë të hapur parkimi, etj.
b) Në rastin e zonave me objekte shërbimi, industriale, me shumëpërdorime, etj., përdorimi i kësaj hapësire do të displinohet me rregullore lokale për trajtimin e hapësirave të lira të bashkisë.
c) Në rastet kur tërheqja vjen si një detyrim ligjor i brezave mbrojtës, kriteret e sigurisë, kanë përparësi në trajtimin e hapësirës së tërheqjes.

14. Të gjithë ndërtimet duhet të ruajnë distancat minimale ngatrupat ujorë (lumenj, përrenj, kanale, etj.,)pavarësisht krijimit apo jo të brezave mbrojtës nga hartat e planit. Në rast mospërputhjeje, distanca më e madhe është detyruese. Në territorin midis vijës së ujit dhe vija e tërheqjes (vija blu) lejohen dhe promovohen ndërhyrje mirëmbajtjeje për të përmirësuar funksionet hidrike dhe vlerat ekologjike. Në ndërtimet e reja që ndodhen midis vijës së ujit dhe Vijës Blu duhet të merret aprovimi përkatës sipas përcaktimeve të ligjit Nr. 111/2012 datë 15.12.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar.

15. Në të gjithë trupat ujorë nëse nuk përcaktohet ndryshe nga organet kompetente, përcaktohet një brez 25 m nga vija më e lartë e ujit ku çdo aktivitet është i ndaluar (vija blu).

16. Përgjatë vijave lumore në një distancë mesatare 200 m synohet krijimi I korridoreve të gjelbër. Zonat ekzistuese (Sistemi urban dhe kategoritë EB –Ekonomi Bujqësore) nuk do të preken dhe do te integrohen në këto korridore, objektet e veçanta në toka bujqësore e natyrore do të shpërngulen në qendrat e banuara.

Neni 47_Leximi i treguesve në tabelat e zonave dhe njësive strukturore

1. Kodifikimi i zonave dhe njësive strukturore është i ndërlidhur.

   Zonat janë kodifikuar sipas 4 parametrave:
   - AB (ose dy gërmat e para) janë akronimi I Bashkisë;
   - CD (ose gërmat e dyta) janë kodi i sistemit territorial;
   - EF (ose gërmat e treta) janë kodi i kategorisë mbizotëruese (% më e lartë) në territorin në fjalë
   - X (ose numri i katërt) është numri rendor i zonave përkatëse që ndodhen brenda në territorin e bashkisë. Nr rendor vjen sipas sistemit ku ndodhet, dmth fillon numërimi nga 1 për çdo sistem.

   Njësitë strukturore janë kodifikuar sipas 5 parametrave:
   - AB (ose dy gërmat e para) janë akronimi I Bashkisë;
   - CD (ose gërmat e dyta) janë kodi i sistemit territorial;
   - EF (ose gërmat e treta) janë kodi i nënkategorisë mbizotëruese (% më e lartë) në territorin në fjalë
   - X (ose numri i katërt) është numri rendor i zonave përkatëse ku ndodhet njësia strukturore.
   - Y (ose numri i pestë) është numri rendor i njësive përkatëse. Nr rendor vjen sipas zonës ku ndodhet, dmth fillon numërimi nga 1 për çdo zone të re.

Kodi I bashkisë	**Sistemi**	**Kategoria mbizotëruese**	**Nr. I zonës**	
DV	UB	A	1	
Kodi I bashkisë	**Sistemi**	**Nënkategoria mbizotëruese**	**Nr. I zonës**	**Nr. I njësisë**
DV	UB	A1	1	1

Shembull_Kodi I Zonës: DV_UB_A_1
Shembull_Kodi I Njësisë Strukturore: DV_UB_A1_1/1

KREU V - Instrumentet për drejtimin e zhvillimit

Neni 48_Përcaktimi i instrumenteve të aplikueshëm për drejtimin e zhvillimit

1. Intensiteti i ndërtimit me kushte, sipas Ligjit Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, është instrumenti i zhvillimit të territorit që synon të sigurojë kontribut për financimin e investimeve kapitale në infrastruktura dhe shërbime publike, përfshirë programet sociale të strehimit, në zona të parashikuara nga plani i përgjithshëm vendor. Ky kontribut jepet nga kërkuesi i lejes së ndërtimit në këmbim të shtimit të intensitetit të ndërtimit, në marrëveshje me autoritetin vendor.
   a. Intensiteti I ndërtimit me kusht, sipas përcaktimeve të këtij neni, përfshin të drejtën e shtimit të numrit të kateve të parashikuara si orientim I lartësisë të

zhvillimit nha ky plan dhe kjo rregullore zhvillimi dhe zbatohet në nivel njësie strukturore, parcele apo grup parcelash.

b. Intensiteti I ndërtimit, përfshirë intensitetin e shtuar, nuk mund të rritet përtej intensitetit maksimal të ndërtimit. Kushtet e tjera të zhvillimit mbeten të pandryshuara ose ndryshohen në përpjestim të drejtë me ndryshimin e intensitetit të ndërtimit, pa cënuar standartet e planifikimit.

c. Kontributi që zhvilluesi do të dhurojë njësisë vendore në këmbim të të drejtës së shtimit të intensitetit sipas këtij program, do të përfshijë minimalisht 15% të sipërfaqës totale shtesë, sipas përcaktimeve të këtij neni.

d. Investimet në infrastrukturë/vepra/shërbime publike që kërkohen nga ana e njësisë vendore në këmbim të një rritjeje të intensitetit të ndërtimit duhet të bazohen në udhëzimet e kuadrit ligjor dhe PPV-së. Përmirësime të mundshme, por duke mos u kufizuar vetëm në to, mund të jenë: a) infrastruktura/vepra publike; b) parqe publike; c) përdorime publike që i përkasin kategorive IN, AS dhe SH; d) tokë për interes publike; e) strehim social; f) zhvillime të tjera me interes publik.

2. E drejta e preferimit, sipas Ligjit Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, është e drejta në dobi të një autoriteti të planifikimit, për t'u preferuar në radhë para çdo personi privat në blerjen, në të njëjtat kushte, të një pasurie të paluajtshme, në pronësi private, që është objekt shitjeje dhe ndodhet në një zonë vendimtare për realizimin ose mbrojtjen e një interesi publik. Ky instrument do të përdoret në njësitë strukturore ku propozohen shkolla dhe qendra shëndetësore të reja, me kategori përdorimi të tokës, primare apo sekondare, AS (arsim) dhe SH (shëndetesi), ku e drejta e preferimit përdoret vetëm për interesin publik konkret, për të cilin është zgjedhur dhe i referohet shërbimeve të reja publike të propozuara.

3. Një tjetër instrument I aplikueshëm për drejtimin e zhvillimit në këtë plan janë Planet e Detajuara Vendore. Ky instument ndërmerret për zonat e rizhvillimit dhe ato të mbushjes urbane, dhe në të gjitha rastet sipas kodeve të njësive në tabelat përkatëse. Gjithashtu Bashkia duhet të hartojë edhe për zonat që nuk janë subjekt I PDV-ve Planet e Zhvillimit të Infrastrukturave Publike, të cilat do të parashikojnë shtrirjen e rrjetit rrugor dhe infrastrukturat e tjera mbi dhe nëntokësore. Në çdo rast këto instrumenta edhe kur janë iniciativa private do të kontrollohen dhe mbikqyren nga autoriteti vendor gjatë procesit të hartimit, në mënyrë që të garantohet zbatimi I PPV dhe mbrojtja e interest publik në zone.

Neni 49_Hartimi I Planeve te Detajuara Vendore

1. Njësitë strukturore të cilat i nënshtrohen hartimit të PDV janë të përcaktuara në hartën treguese dhe në pasaportat parametrike të treguesve të zhvillimit në vijim të kësaj rregulloreje.

2. Hartimi i PDV për çdo njësi, bëhet në një fazë dhe dokumentacioni do të përmbajë:

- Planin e detajuar të përdorimit të tokës dhe të strukturave në të, në përputhje me kategoritë dhe nënkategoritë e përdorimit sipas përcaktimeve në këtë rregullore dhe Planin e Përgjithshëm Vendor;
- Shpërndarjen e treguesve të zhvillimit dhe të planifikimit për çdo zone zhvillimi në nivel parcele, tipologjitë e ndryshme të ndërtimeve dhe vendosjen e tyre në lidhje me kufijtë e pronave dhe rrugët, balancimin e interesave të palëve, përfshirë Bashkinë Delvinë;
- Plani teknik i rrjeteve inxhinierike dhe shërbimeve të zonës, për realizimin e punimeve në infrastrukturë dhe shërbime.
- Hapësirat për strukturat me interes publik, të tipit sheshe publike, zona të gjelbra, shkolla etj., dhe orientime volumetrike mbi trajtimin e tyre nga pikëpamja e projektimit urban;
- Mënyrën e plotësimit të elementeve të tjerë të nevojshëm për kontrollin e zhvillimit në territor sipas përcaktimeve të VKM nr.686, dt.22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit" (i ndryshuar).

3. Intesiteti i përcaktuar i nënnjësisë nënkupton atë mesatar. Në ato nënnjësi të cilat do të kenë PDV intesiteti për cdo parcelë do të përcaktohet nga plani i detajuar vendor. Objektet e propozuara përgjatë rrugëve do të trajtohen me intesitet maksimal në funksion të përmirësimit të rrugëve ekzistuese, si dhe krijimit të rrugëve të reja. Hartimi I PDV-së do të sigurojë shpërndarjen e barabartë proporcionalisht të treguesve të zhvillimit për secilën zonë zhvillimi. Realizim proporcionalisht i barabartë do të thotë një diferencë jo më e madhe se 0.5 për intensitetin, brenda secilës zone menaxhimi, pjesë të një zone zhvillimi.

4. Nëse PPV-ja përcakton se një zonë nuk do të zhvillohet me PDV, por ajo ka nevojë për ndërhyrje ristrukturuese (dendësim/mbushjeurbane/konsolidim/rigjenerim/urbanizim/rizhvillim), ajo duhet të plotësohet me infrastrukturë të re rrugore. Bashkia realizon me fondet e veta ose në bashkëpunim me subjektet e interesuara për zhvillimin e zonës projekt-idenë për ristrukturimin e rrjetit rrugor si dhe shtrirjen e infrastrukturës së re, para se të vijojë me dhënien e lejeve të zhvillimit dhe të ndërtimit.

Neni 50_Ndarja e bashkimi i parcelave për qëllime zhvillimi dhe detyrimet përkatëse

1. Të gjitha rastet e nënndarjes dhe bashkimit të parcelave, mbi bazën e të cilave kryhet një proces zhvillimi, përcaktohen si nënndarje dhe bashkim për qëllime zhvillimi.

2. Kushtet për realizimin e nënndarjes dhe bashkimit të parcelave për qëllime zhvillimi përcaktohen nga çdo autoritet planifikimi në dokumentet e planifikimit dhe në zbatim të kushteve të zhvillimit.

3. Plani i nënndarjes dhe bashkimit të parcelave për qëllime zhvillimi realizohet si pjesë e PDV-ve.

4. Parcelat e reja të krijuara nga procesi i nënndarjes dhe bashkimit regjistrohen në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme vetëm pasi rrjeti rrugor dhe infrastrukturat për secilën parcelë të re të krijuar nga nënndarja të jenë ndërtuar në përputhje me planin e miratuar të nënndarjes dhe regjistruar në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme, në përputhje me marrëveshjen midis zhvilluesit/pronarit dhe autoritetit vendor të planifikimit.

5. Infrastrukturat që regjistrohen në pronësi të pronarëve private të parcelave detyrimisht mirëmbahen prej tyre në përputhje me kushtet kohore, teknike dhe të cilësisë, të vendosura për këtë qëllim nga njësia e qeverisjes vendore e cila vazhdimisht kontrollon cilësinë e këtyre infrastrukturave.

6. Nuk lejohet nënndarja në tokat me gjeo-rreziqe apo ku nënndarja mund të krijojë mundësi për gjeorreziqe, përmbytje dhe pengesa në sistemin e kullimit të ujërave.

7. Nëse parcela e ndërtimit ndahet në dy njësi strukturore atëherë llogaritjet e parametrave të zhvillimit bëhën në për secilën pjesë të parcelës dhe më pas mblidhen për tu zbatuar në një objekt të vetëm. Vetëm në rastin e lartësisë dhe numrit të kateve merret parasysh numri dhe lartësia e kateve e njërës nga dy njësitë strukturore e cila e ka më të lartë këtë parametër.

Neni 51_Kushtet e përgjithshme të ndarjes së parcelave për qëllime zhvillimi

1. Kushtet e përgjithshme për lejimin dhe realizimin e nënndarjes së parcelës për qëllime zhvillimi janë:
   - parcela duhet të ndodhet brenda kufijve të sistemit urban (vija e gjelbër) ose në ato pjesë të sistemit natyror dhe bujqësor që janë përcaktuar për t'u konvertuar në tokë 'truall" nga PPV dhe aktet përkatëse ligjore në fuqi;
   - çdo parcelë që ka sipërfaqe të mjaftueshme për t'u nënndarë disa herë dhe në më shumë se dy parcela. Siperfaqja minimale e parcelave vetëm në rastet e ndarjes është 500m².
   - në zonat e përcaktuara nga PPV për t`u zhvilluar me PDV, nënndarja ndodh vetëm një herë dhe në bazë të planit të nëndarjes në PDV.
   - parcelat e reja të krijuara pas procesit të nënndarjes duhet të kenë lidhje të drejtpërdrejtë me rrugën dhe infrastrukturat publike. Madhësia e daljes së çdo parcele në rrugë kushtëzohet nga vendndodhja tyre në lidhje me rrugën, përcaktohet në përputhje me standardet e Kodit Rrugor dhe në çdo rast është jo më pak se 6 m;
   - sipërfaqja e parcelave për infrastrukturën, të përftuara nga procesi I nënndarjes për qëllime zhvillimi, përcaktohet në përputhje me nevojat e infrastrukturës publike që ndërtohet.
   - nëse nënndarja kërkohet në një zonë për të cilën plani nuk parashikon hartimin e PDV-së, pronari duhet të përgatitë planin e nëndarjes, i cili është i domosdoshëm për të kryer të gjitha procedurat e zhvillimit në vijim, sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Në këto raste nëndarja mund të realizohet disa herë, por gjithmonë për parcelat që krijohen nga nënndarja paraardhëse dhe në bazë të një plani përkatës të nënndarjes.

- çdo plan i nënndarjes miratohet nga Kryetari i Bashkisë.
- plani i nënndarjes përfshin hartën e pronësive të reja që rezultojnë nga nënndarja, funksionet e lejuara për çdo parcelë, rrjetin rrugor, hapësirat e tjera publike nëse ka të tilla, si dhe kufizimet e distancave, vëllimit ndërtimor, intensitetit, dhe koefiçientit të shfrytëzimit të tokës për ndërtim për çdo parcelë që përftohet nga nënndarja, të vizatuara dhe me vlerë numerike.

Neni 52_Bashkimi i parcelave për qëllime zhvillimi dhe detyrimet përkatëse

1. Bashkimi i parcelave për qëllime zhvillimi kryhet me vullnetin e pronarëve të tyre, si pjesë e PDV-ve apo përmes lejeve kur:
   - zhvillimi i ri ndryshon përdorimin dhe/ose treguesit e planifikimit dhe kushtet e zhvillimit në parcelën e krijuar nga bashkimi, nga ato ekzistuese;
   - zhvillimi i ri kërkon krijimin e një parcele të re, me formë dhe përmasa të ndryshme nga parcelat ekzistuese të cilat bashkohen.

2. Bashkimi i parcelave për qëllime zhvillimi është kusht për vijimin e zhvillimit nëse sipërfaqja e pronës për të cilën kërkohet zhvillimi nuk përputhet me parcelën minimale sipas kësaj rregulloreje.

3. Fazat e zbatimit të bashkimit dhe instrumentet financiare, të drejtimit të zhvillimit sipas ligjit dhe të realizimit të hapësirës publike sipas ligjit, përcaktohen në PDV ose në lejen përkatëse, sipas rastit.

4. Në rastet kur bashkimi i parcelave kryhet përmes një lejeje, plani i bashkimit të parcelave, fazat e zbatimit të bashkimit dhe instrumentet e financimit janë pjesë e projektit që shoqëron kërkesën për leje.

5. Gjatë realizimit të bashkimit për qëllime zhvillimi, zbatohen instrumentet financiare të drejtimit të zhvillimit sipas ligjit.

6. Parcelat e reja të krijuara pas procesit të bashkimit duhet të kenë lidhje të drejtpërdrejtë me rrugën dhe infrastrukturat publike. Madhësia e daljes së çdo parcele në rrugë kushtëzohet nga vendndodhja tyre në lidhje me rrugën, përcaktohet në përputhje me standardet e Kodit Rrugor dhe në çdo rast është jo më pak se 6 m.

Neni 53_Ristrukturimi i Strukturave Ekzistuese

1. Proçesi i ristrukturimit te strukturave ekzistuese perfshin veprimet e nderhyrjes per rivleresimin apo rindertimin e strukturave ekzistuese.

2. Proçesi i ristrukturimit lejohet pa nevojën e hartimit të planit të detajuar vendor, pavarësisht përcaktimeve për njësinë strukturore.

3. Në rastet kur ristrukturimi i strukturës ekzistuese parashikon zhvillimin apo shtimin pjesor volumetrik anësore apo në lartësi, të strukturave ekzistuese në territor,

propozimi do të shoqërohet gjatë aplikimit për Leje Zhvillimi, me vendosjen e strukturës të propozuar për shtim apo plotësim të volumetrisë ekzistuese në raport me volumetrinë urbane ekzistuese, duke pasqyruar në plan dhe volumetri impaktin urban të propozimit sipas kushteve ligjore të distancave apo shfrytëzimit të territorit në fuqi.

4. Në të gjitha rastet kur ndërhyrjet për ristrukturim parashtrojnë dhe nevojën e shtesës volumetrike, kjo e fundit do të lejohet vetëm në respektim të kushteve ligjore të bashkëpronësisë sipas parashikimeve të përcaktuara në Kodin Civil në fuqi me miratimin e jo më pak se ¾ të bashkëpronarëve të ndërtesës, apo në vlerësim të kushteve teknike të strukturës dhe kushteve arkitektonike, të cilat e lejojnë ndërhyrjen.

5. Ristrukturimi përfshin edhe proçesin e rindërtimit, për ato raste të ndërtesave të degraduara strukturalisht apo që përbëjnë rrezik për banorët e ndërtesave, për të cilat lejohet proçesi i shëmbjes dhe rindërtimit edhe në zonat e konservimit, me kushtin e respektimit të gjurmës dhe kushteve urbanistike të strukturës origjinale. Në rastin rindërtimit apo ristrukturimit të një strukture monument kulture apo pjese të një ansambli kulturor, çdo ndërhyrje do të lejohet vetëm pas miratimit të organeve kompetente për pasuritë, sipas ligjit për pasuritë kulturore në fuqi.

6. Në të gjitha strukturat buzë rrugëve kryesore dhe dytësore, shtesat lejohen vetëm për ndërhyrje nga autoritetet vendore, në respektim të politikave të zhvillimit për interes publik, për stimulimin e ristrukturimit të arkitekturës urbane dhe rigjenerimit pejsazhik të rrugëve kryesore dhe dytësore të qytetit.

7. Proçesi i ristrukturimit mundëson mbylljet e plota apo të pjesëshme të verandave apo terracave të shfrytëzueshme për shfrytëzim individual, në rastin kur këto gëzojnë titullin e pronësisë, me kushtin e respektimit të distancave të ndriçimit apo në rastet kur ndërhyrja nuk cënon arkitekturën pejsazhike të bllokut. Në të kundërt, në rastin e bashkëpronësisë, çdo ndërhyrje do të lejohet në respektim të kushteve ligjore në fuqi.

8. Në rastet kur ristrukturimi parashikon mbylljet e plota apo të pjesëshme të verandave apo terracave të shfrytëzueshme për shfrytëzim individual, apo në rastet kur parashikohet mbyllja e ballkoneve, kërkesa do të shoqërohet me projekt-idenë e zhvillimit e cila përcakton kushtet dhe mënyrën e ndikimit në fasadën origjinale të strukturës. Autoritetet vendore të planifikimit do të gjykojnë rast pas rasti duke prioritizuar ruajtjen dhe unifikimin e ndërhyrjes në fasadë dhe arkitekturë. Vendimmarrja mund të kushtëzojë dhe ndërhyrje vetëm në ato raste kur ristrukturimi prek të gjithë fasadën e strukturës.

9. Proçesi i ristrukturimit, mënyrat e ndërhyrjes së rivlerësimit dhe proçesi I miratimit rregullohen sipas rregulloreve të zhvillimit dhe ligjit të planifikimit në fuqi, nëpërmjet autorizimit apo aplikimit për Leje Zhvillimi në varësi të tipologjisë të ndërhyrjes në strukturë.

KREU VI - Rregullat e sistemit rrugor, transportit dhe hapësirave publike

Neni 54_Përcaktimi i kategorive të rrjetit rrugor, në përputhje me legjislacionin e posaçëm

1. Klasifikimi i Rrjetit Rrugor mbështetet në Kodin Rrugor të Republikës të Shqipërisë Ligji nr.8378 datë 22/07/1998, i ndryshuar, në perputhje me "destinacionin" e rrugëve urbane dhe me rritjen e pritshme urbane dhe territoriale.

2. Harta e Rrjetit Rrugor të Bashkisë Delvinë përcakton brënda kufijve administrative kategoritë, referuar nenit 2 të Kodit Rrugor. Sipas karakteristikave të tyre konstruktive, teknike dhe funksionale rrugët klasifikohen si më poshtë:

Hierarkia e Sistemit Rrugor

RRJETI INTERURBAN _ Rrugët interurbane lidhin qendrat urbane me rajone të tjera, qytetet dhe vendet me interes në te gjithë vendin. Ato ndryshojnë në qëllim, gjerësi dhe në shpejtësinë e udhëtimit, duke filluar nga autostradat deri tek rrugët e vogla rajonale të qendrave urbane dhe të fshatrave, gjë që ka një ndikim relativ në moderimin e kufijve të shpejtësisë. Në kuadër të Planit, rrugët ndërurbane mendohen të jenë:

Rrugët Interurbane Dytesore (Kat. C) _ Segmenti ekzistues i Rrugës Delvinë – Qafë Muzinë dhe aksi Kardhiq - Delvinë

Rrugë Lokale (F) _ Të gjitha rrugët e tjera të proposuara jashtë kufijve të vendbanimeve përfshirë lidhjet ndërmjet vendbanime të vecanta dhe/ose zonave në zhvillim.

RRJETI URBAN _ Rrugët urbane përbëjnë pjesë të rrjetit rrugor, që shtrihet brenda vendbanimeve urbane dhe rurale të bashkisë. Ato ndryshojnë në madhësi dhe në shpejtësinë e udhëtimit, duke filluar nga rrugët kryesore në rrugë vetëm për këmbësorë. Të gjitha rrugët urbane duhet të lehtësojnë qarkullimin e këmbësorëve, prandaj trotuaret janë të nevojshme. Për më tepër, shumica e tyre kanë nevojë për të mbuluar nevojat e rastit për parkime në rrugë. Madhësitë e trotuareve dhe numri i vendeve të parkimit, duhet të përcaktohen rast pas rasti, sipas nevojave dhe tipareve hapësinore të çdo vendbanimi. Më konkretisht rrugët urbane përfshijnë:

Rrugët Urbane Kryesore (D) _ Rrugët kryesore që sigurojnë hyrje dhe mbajnë trafik për në zonat urbane.

Rrugët Lokale (F) _ Rrjeti i mbetur rrugor që shërben për hyrjen e mjeteve në blloqet individuale të banimit.

Rrjeti i rrugëve këmbësore _ Rrjeti i rrugeve këmbësore dhe hapësirave të hapura përcaktojnë qarkullimin e këmbësorëve brenda zonës së vendbanimit.

Neni 55_Kushtet teknike dhe përmasat

1. Seksionet e çdo kategorie të dhënë në këtë Rregullore percaktohen sipas "Standartit të Projektimit dhe të Ndërtimit të Rrugëvë Shqiptare", "Metodikës të Hartimit të PUT" dhe Kriteret Teknike të Rregullimit të Qarkullimit në Qëndrat Urbane - MTI

2. Këto seksione për secilën kategori të rrugëve është dhënë në hartat e zhvillimit të Rrjetit Rrugor të Qytetit dhe të Bashkisë Delvinë. Mbi këtë bazë, Bashkia ka të përcaktuar kufijtë (seksionet) e rrjetit të ardhshëm rrugor të cilat nuk mund të preken, pavarsisht kohës kur do të ndërhyhet për rikonstruktimin e këtyre rrugëve me seksionet e dhëna.

3. Rrjeti rrugor, duhet egzaminuar duke u mbështetur në të gjithë aspektet e veçorive të tij si :
   - karakteristikat urbane të rruges ose të pjesëve të vecanta të saj (rezidenciale, tregtare, industriale, etj.);
   - organizimi dhe karakteristikat kryesore gjeometrike të rrugës (gjerrësia e rrugës dhe e trotuareve, numrin dhe përmasat e korsive, ndarësit e trafikut, bankinat, pendenca dhe kurbëzimet e veçanta , etj.);
   - drejtimet e qarkullimit, ndalimet e kthimit dhe kategoritë e automjeteve të lejuara për qarkullimin (organizimin e qarkullimit);
   - praninë e linjave të transportit kolektiv (shërbimet urbane, ekstra urbane, etj);
   - ekzistenca e pengesave fizike pemë, distributorë karburanti, etj;
   - lloji dhe kapaciteti i lejuar i vendqendrimeve dhe i ndalim qëndrimeve në rrugë dhe zona të hapura për publikun;
   - aftësitë e zonave, jashtë njësive rrugore, të përdorshme për vendqendrimin e automjeteve;
   - prania e ndriçimit rrugor.

Neni 56_Kushtet teknike sipas kategorive të rrugëve

1. C - RRUGË INTERURBANE DYTËSORE: Rrugë me një karrexhatë 9m minimalja dhe 10.5m maksimalja, me një korsi 3.5m lëvizjeje për sens dhe bankine 1m dhe nga 1m në anën e jashtme të karrexhatës e cila shërben për zgjerim rruge. Rrugët që përkasin kategorisë C janë SH78, e cila lidh Sarandën me qytetin e Delvinës dhe me dalje në Muzinë, Finiq si edhe Aksi rrugor (në ndërtim pjesërisht) Kardhiq - Delvinë.

Rruge Interurbane Dytesore
kat. C_{min}= 9 m



Rruge Interurbane Dytesore
kat. C_{max}= 10.5 m



2. E - RRUGË URBANE DYTËSORE:

- Rrugë me një karrexhatë me të paktën dy korsi 3m dhe trotuar në anën e jashtme të karrexhatës e cila shërben për qarkullimin e këmbësorëve 1.5-4.5m. Në këtë kategori përkasin rrugët të cilat gjenden në qëndrën urbane të Delvinës.
- Rrugë me një karrexhatë me të paktën një korsi për sens 3m, parkim 2m në një anë të karrexhatës dhe trotuare në anën e jashtme të karrexhatës e cila shërben për qarkullimin e këmbësorëve 1.5- 4.5m.

Rruge Urbane Dytesore
kat. E_{min}= 10 m



Rruge Urbane Dytesore
kat. E_{max}= 18 m



3. F - RRUGË LOKALE:
   - Rrugë lokale 7.5m, me një korsi 2.75m lëvizjeje për sens dhe bankinë 1m e sistemuar në mënyrë të përshtatshme për përdorim publik e destinuar për qarkullimin e këmbësorëve, biçikletave dhe kafshëve. Ky klasifikim rruge i jep përparësi krijimit të hapësirave publike për ndërveprim shoqëror, mobilimit urban dhe qarkullimin e këmbësorëve, kafshëve dhe biçikletave.
   - Rrugë lokale, e sistemuar në mënyrë të përshtatshme për përdorim publik e destinuar për qarkullimin e këmbësorëve, mjeteve dhe kafshëve. Rrugë me një karrexhatë me të paktën një korsi 3m lëvizjeje për sens dhe trotuar në anën e jashtme të karrexhatës e cila shërben për qarkullimin e këmbësorëve 1.0 – 3.0m.
   - Rrugë lokale, e sistemuar në mënyrë të përshtatshme për përdorim publik e destinuar për qarkullimin e këmbësorëve, biçikletave dhe kafshëve. Ky klasifikim rruge i jep përparësi krijimit të hapësirave publike për ndërveprim shoqëror, mobilimit urban dhe qarkullimin e këmbësorëve, kafshëve dhe biçikletave. Rrugë me një korsi biçikletash 1.6m dhe trotuar në anën e jashtme të karrexhatës e cila shërben për qarkullimin e këmbësorëve 1.4m.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA DELVINË

Rruge Lokale
kat. F_{min}= 7.5 m



Rruge Lokale
kat. F_{max}= 13 m



Neni 57_Normat e respektimi e vijave të kufizimit të ndërtimeve kundrejt të gjithë kategorive të rrugëve

1. Distanca e ndërtimeve nga trupi rrugor është jo më pak se 5 m nga trupi i rrugës, në rastin e rrugëve lokale, brenda zonave të banuara dhe 20m jashtë zonave të banuara.

2. Distanca e ndërtimeve nga trupi rrugor është jo më pak se 5 m nga trupi i rrugës, në rastin e rrugëve urbane dytësore, brenda zonave të banuara. Për sa kohë që nuk bie në kundërshtim me Kodin Rrugor, në rastet kur zgjidhet tipologjia e ndërtesave të gjata ose të bashkangjitura mur urban, kjo distancë është 0m, por trotuari është jo më pak se 6m i gjerë.

3. Distanca e ndërtimeve nga trupi rrugor është jo më pak se 10 m nga trupi i rrugës, në rastin e rrugëve interurbane dytësore, nëse rruga kalon brenda zonave të banuara dhe 30m jashtë zonave të banuara.

4. Distancat për muret rrethuese që ndërtohen përgjatë rrugëve janë përcaktuar në kodin rrugor. Kur ato nuk janë të përcaktuara për kategori të caktuara, atëherë zbatohet distanca 5 m nga trupi i rrugës.

Neni 58_ Pemët që mbillen në trotuare dhe ndriçuesit

1. Pemët që mbillen në trotuare dhe ndriçuesit që vendosen në trotuare, duhet të pozicionohen në mënyrë të tillë që të lejojnë një distancë minimale prej të paktën 1.3 metra të lirë për kalimin e pashqetësuar të këmbësorëve. Kjo distancë matet nga kufiri i jashtëm i gropës së mbjelljes së pemës, nëse gropa e mbushur me dhe nuk mbulohet por sistemohet me trotuar betoni, ose nga trungu i pemës nëse gropa e mbushur me dhe mbulohet me zgarë metalike të përshtatshme për ecje, ujitje të pemës dhe mirëmbajtje.

Neni 59_Parametrat e skemës së lëvizshmërisë dhe të transportit publik, në përputhje me legjislacionin e posaçëm

1. Rrugët e veçanta në Qytetin e Delvinës janë grupuar në rrjete rrugore sipas hierarkisë kategorive qe janë klasifikuar këto rrugë, bazuar në funksionin e përbashkët të rrjetit rrugor, territorit, dhe vetë sistemit rrugor. Faktorët themelorë, të cilët e karakterizojnë rrjetin rrugor nga këndvështrimi funksional janë:
   - (hyrje-daljet); ku janë marrë parasysh lëvizja në të dyja kahet;
   - distancat gjatë drejtimit të mjeteve;
   - funksioni në lidhje me territor (p.sh. lidhjet lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare);
   - përbërja e trafikut dhe kategoritë përkatëse (mjete të lehta, mjete të rënda, motoçikleta, këmbësorë, notorçikleta, këmbësor, etj.).

2. Kriteri bazë i projektimit të skemës së lëvizshmërisë, është parashikimi i lidhjes së çdo rruge, vetëm me rrugë të tjera të të njëjtës kategori ose të kategorisë paraardhëse ose pasardhëse.

3. Transporti Publik duhet të organizohet për të siguruar mundësinë e mobilitetit të qytetarëve në rrjetin kryesor urban si transporti më efektiv, më ambjental në gjithë rrugët primare dhe sekondare urbane , nuk lejohet në rrugët lokale urbane. Shërbimi i transportit qytetës të udhëtarëve në Bashkinë Delvinë do te jete I organizuar nga strukturat përkatëse të saj në përputhje me Ligjin Nr.8308.dt.18.03.1998 "Për Transportet Rrugore", (i ndryshuar), Ligjit Nr.8378.dt.22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", (i ndryshuar) si dhe udhëzimeve të tjera të fushës së transportit që në thelb kanë disiplinimin e parametrave tekniko – ekonomik që operatorët duhet të plotësojnë në lidhje me kushtet e kryerjes së shërbimit.

4. Rregullime në infrastrukturën e ofruar për të siguruar një shërbimi transporti public të shpeshtë, të shpejtë, të besueshëm dhe konfort:
   - të përmirësohet infrastruktura e stacioneve të autobuzëve me të gjithë elementët e nevojshëm për t'ju siguruar akses të gjithë përdoruesve si psh. Ulja e trotuarëve, vendosja e kabinave, informimi i qytetarëve etj;
   - të përcaktohen korsi të veçanta për autobuzë në rrugët kryesore dhe dytësore;
   - të vendoset sistemi i biletave të unifikuara për të gjitha linjat dhe shoqëritë etransportit;
   - kondicionimi: 100 % i mjeteve të transportit;
   - mjetet duhet të jenë të pajisura me pajisje të veçanta për invalidët.

5. Lëvizja me mjete alternative si një element i rëndësishëm për plotësimin e skemës së transportit multimodal është dhe lëvizja me biçikleta. Në të gjitha projektet që do të aplikohen nga Bashkia është e rëndësishme ndjekja e parimit të mëposhtëm në projektim. Kjo mënyrë projektimi vjen si një zbatim i strategjisë së transportit multimodal në qytetin e Delvinës dhe parashikon sistemimin e infrakstrukturës sipas parimit të shpërndarjes së sipërfaqes të rrugës për cdo përdorues duke i dhënë prioritet shërbimit publik, lëvizjes me bicikleta dhe lëvizjes këmbësorëve. Në vijim jepen disa standarte që duhet të konsiderohen gjatë projektimit të korsive të biçikletave.
   Korsitë:

- gjerësitë e korsive variojnë duke patur parasysh dimesionet e biçikletës dhe balancës të përshtashme në lidhje me hapësirën e lirë dhe pengesat;
- gjerësia e korsisë së biçikletës duhet të jetë 1.5 deri 1.8 m për një drejtim lëvizje;
- gjerësia e korsisë me dy drejtime (vajtje –ardhje) duhet të jetë minimumi 2.5 m.

Në raste të veçanta për të mundësuar zgjidhjen në mungesë të hapësirës:
- një korsi, për gjerësi minimale mund të jetë deri 1 m;
- dy korsi, për gjerësi minimale mund të jetë deri 2 m;
- rrezja e kthimit duhet të jetë më e madhe se 5m.

Korsitë e biçikletave duhet të ndahen qartësisht nga mënyrat e tjera të levizjes me anë të një brezi sigurie i cili ka një minimum gjerësie prej 0.5 m. Struktura e korsive të biçikletave:
- rrugë me shtrese betoni te stampuar me ngjyrë të veçantë;
- rrugë me shtrese asfalti të stampuar me ngjyrë të veçantë;
- rrugë me pllaka betoni me ngjyre të veçantë.

Shpejtësia e lëvizjes së bicikletës:
- çiklistët duhet të lëvizin (pedalojnë) me një shpejtësi prej 20-25 km/orë;
- në korsi me pjerrësi prej 5% shpejtësia duhet të arrijë deri në 40 km/orë .

Sinjalistika e nevojshme dhe stacionet e qëndrimit: Për të drejtuar fluksi e çiklistëvë do të përdoret:
- sinjalikë horizontale e verdhe;
- sinjalikë vertikale;
- stacione qëndrimi.

Neni 60_Rrjetet dhe infrastruktura

1. Të gjitha strukturat duhet të lidhen me rrjetet infrastrukturore të ujit të pijshëm, kanalizimeve, ujërave të shiut, energjisë elektrike si dhe shërbimit të grumbullimit të mbeturinave. Lidhjet duhet të jenë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe specifikimet teknike.

2. Infrastrukturat e telekomunikacionit mund të vendosen në territore ku kategoria bazë është e përcaktuar si Infrastrukturë telekomunikacion dhe/ose në pëputhje më përdorimet e lejuara/ kushtëzuara të njësive përkatese, në të gjitha rastet ngarkohet bashkia të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse për infrastrukturat tokësore apo nëntokësore për telekomunikacionin.

3. Lidhjet me rrjetet e infrastrukturës së telekomunikacionit apo të rrjetit elekrik në fasadat e ndërtesave të reja apo rikonstruksionet, rehabilitimet e ndërtimeve ekzistuese do të kryhen përmes kanalinave dhe veshjeve të brendshme për të mos shqetësuar fasadën e ndërtesës, në dakordësi me pronarin/pronarët e ndërtesës ose banesës.

4. Të gjitha ndërtimet e reja apo rikonstruksionet, rehabilitimet duhet të sigurojnë aplikimin e normativës në fuqi për mbrojtjen nga zjarri, sipas dispozitave të ligjit Nr. 152/2015, datë 21.12.2005, i ndryshuar "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin".

5. Nuk lejohet përzierja e shkarkimit të ujrave të bardha me rrjetin e kanalizimeve të ujrave të zeza. Vetëm shkarkimet e ujrave të shiut do të mund të bashkohen me rrjetin e kullimit të ujrave të bardha.

6. Në zonat industriale, të gjithë stukturat do të bëjnë shkarkimin e ujrave pasi të jenë trajtuar dhe pastruar nga substancat ndotës në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr. 9115, datë 24.7.2003, "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", gjithashtu ndërtesat duhet të respektojnë ndërtimin e infrastrukturave në zbatim të VKM-së Nr. 520 datë 25.07.2019 "Për miratimin e rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin".

7. Hapja e puseve, qoftë për përdorim vetjak, bujqësor apo industrial, duhet të kryhet nga shpuesit profesionistë të licencuar dhe pasi janë pajisur me leje shfrytëzimi nga organet e menaxhimit të burimeve ujore, në zbatim të dhe perputhje me Ligjin Nr. 111/2012, datë 05.11.2012 "Për Menaxhimin e Integuar të Burimeve Ujore".

8. Për shtëpitë e veçuara në zona rurale, rekomandohet mbledhja dhe dekompozimi i mbetjeve organike në puse/ gropa të vendosur të paktën në distancë 5 m nga perimetri i ndërtesës/ banesës.

9. Mbetjet organke bujqësore duhet të mblidhen dhe dekompozohen në vende të përcaktuara, ku në çdo rast duhet të jenë minimumi 100 m nga perimetri i ndërtesave me funksion banimi.

Neni 61_Aksesi

1. Aksesi i përshtatshëm në parcelë, është kusht i nevojshëm për lëshimin e një leje zhvillimi në atë parcelë.

2. Rrugët e hyrjes duhet të sigurojnë akses për makineritë gjatë ndërtimit dhe për zjarrfikëset, duke siguruar një rrugë kalimi së paku prej 4 metrash, të përshtatshme për mjetet me tonazh të lartë. Objektet e mëdha duhet të sigurojnë më shumë se një rrugë kalimi.

Neni 62_Hapësirat publike dhe përdorimi publik

1. Projektimi i hapësirave publike dhe përdorim publik, edhe në rastin e rikualifikimit të hapësirave ekzistuese, duhet të jetë e orientuar në mënyrë që të zbatojë dhe promovojë politikat vendore dhe sigurinë ambjentale, me objektiv parandalimin e krimit e akteve të dhunshme dhe mbështetje të interesit publik.

2. Për këtë qëllim projektimi i parkimeve duhet të evitojë përqëndrimin e tyre në zona të pa aksesueshme; gjithashtu projektimi i hapësirave të gjelbra duhet të studiohet në raport me sipërfaqen e tyre, mundësinë për të garantuar funksionimin e rrjetit rrugor dhe shikueshmërinë në qarkullimin rrugor.

3. Mobilimi urban i hapësirave të destinuara për këmbësorë, dhe trotuarët duhet të parashikohet e diferencuar në material dhe ngjyrë nga karrexhata, në mënyrë që të lehtësojë lëvizjen e këmbësorëve dhe eleminimin e barrierave arkitektonike për lëvizjen e personave me aftësi të kufizuar.

4. Në prezencë të bimësisë, shkurreve dhe pemëve, terreni duhet të realizohet duke përdorur teknologjitë e drenazhit urban për të lehtësuar fluksin e ujrave dhe vaditjen artificiale.

5. Trotuarët duhet të garantojnë kalimin e këmbësorëve duke ruajtur gjerësinë minimalisht 1.2m.

6. Gjerësia trotuarëve duhet të garantojë instalimin e sinjalistikës rrugore vertikale, ndriçimit rrugor dhe gjelbërimin, sipas projektit përkatës.

7. Shërbimet shëndetësore janë përcaktuar me një rreze shërbimi 1500 m dhe në mënyrë të tillë që të plotësojnë nevojat e të gjithë territorit, në përgjigje të përfundimeve nga analiza e periferialitetit. Bashkia do të ketë 8 qendra shëndetësore (nivele të ndryshme) 1 spital dhe 1 poliklinikë.

8. Shërbimet arsimore janë përcaktuar me rreze shërbimi, për shkollat 9-vjeçare 550m në zona urbane dhe 1250m në zonat rurale si dhe për shkollat e mesme 1250m në zonat urbane dhe 3250m në zonat rurale dhe në mënyrë të tillë që të plotësojnë nevojat e të gjithë territorit, në përgjigje të përfundimeve nga analiza e periferialitetit. Bashkia do të ketë 16 shkolla fillore dhe nëntëvjeçare publike ku janë të integruara edhe kopshtet dhe çerdhet, 1 shkollë të mesme. Parcela minimale e një shkolle të parashikuar është 1,500-7,000 m^2 për shkollat 9-vjeçare dhe 2,000-7,000 m^2.

KREU VII - Rregullat e ruajtjes së mjedisit, peizazhit, burimeve natyrore, zonave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore

Neni 63_Normat dhe standardet për zhvillimet, që kanë ndikim në mjedis, shëndet, peizazh dhe në trashgimi kulturore

1. Normativa e caktuar në legjislacionin kombëtar dhe atë të Bashkimit Europian, do të respektohet dhe në zhvillimin e ardhshëm të planifikua, duke respektuar standardet si më poshtë:

    a. Normat për ajrin urban

Normat e BE	Grimcat e Pluhurit		Dioksid Squfuri	Ozoni	Monoksid Karboni	Dioksidi i Azotit	Benzeni
	PM 10 µg/m³	PM 2.5 µg/m³	SO2 µg/m³	O3 µg/m³	CO µg/m³	NO2 µg/m³	Benzeni µg/m³
1 orëshe			350			200	
8 orëshe				120	10		
24 orëshe	50		125				
Vjetore	40	25				40	5

b. Normat e elementëve kimike në Ujë

Nr.	**Elementët kimike**	**Norma shqiptare**	**Norma e BE-së**
1	Ph	6.5-8.5	6.5-8.5
2	Lëndët në pezulli	≤30	≤25
3	Amoniak	0.05	0.01
4	Nitrite	0.005	0.001
5	Nitrate	≤15	≤0.5
6	Fosfate	≤0.7	≤0.2
7	Nevoja Kimike për Oksigjen	≤20	≤20

c. Standardi për nivelin e zhurmave

Standardi OBSH	**Laeq/Diten dB (A)**	**Laeq/Naten dB (A)**
	55	45

2. Njësitë strukturore të cilat do ti nënshtrohen rizhvillimit nëpërmjet PDV, duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet e Legjislacionin ne fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor që shoqëron PPV.

3. Hartimi i Planeve të Detajuara Vendore do të shoqërohet dhe mbështetet në Raportin e Vlerësimittë Ndikimit në Mjedis të zhvillimeve të propozura në njësitë strukturore përkatëse.

4. Gjerësia e brezit mbrojtës sanitar varion në varësi të aktivitetit si:
   - landfill-in sanitar të mbetjeve urbane është të paktën 200 m dhe brezi do të mbillet me bimësi të lartë dhe shkurre, me kushtin që bimësia të jetë vendase e që ka zhvilluar rezistencë ndaj fenomeneve natyrore dhe sëmundjeve në vite.
   - incinerator-in është të paktën 200 m dhe brezi do të mbillet me bimësi të lartë dhe shkurre, me kushtin që bimësia të jetë vendase e që ka zhvilluar rezistencë ndaj fenomeneve natyrore dhe sëmundjeve në vite.

- objektet industriale të të paktën 50 m dhe brezi do të mbillet me bimësi vendase dhe që ka resistencë të njohur shkencërisht ndaj faktorëve industrial që ndotin tokën, ajrin dhe ujërat.
- varrezat është të paktën 50 m dhe territori do të mbillet me blirë, rrape, qiparisa apo pemë të tjera që mund të vlerësohen më të përshtatshme sipas një studimi përkatës. Distanca e vijës kufizuese të varrezave nga ndërtimi më I afërt është jo më pak se 300 m.
- impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura është 100 m dhe do të mbillet me bimë vendase.

5. Distancat minimale të funksioneve të mëposhtme nga kufiri përfundimtar I qendrës së banuar më të afërt sipas njësive strukturore apo i ndërtesës së banimit më të afërt janë:
   - për krematoriumin në zonën spitalore: të paktën 150 m;
   - për objektet e ndërtimet e lejuara në tokë bujqësore me qëllime bujqësore: Sipas VKM-së nr 283, datë 1.4.2015, "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në tokë bujqësore", I ndryshuar. Kjo VKM përcakton edhe të gjitha rregullat për distancat e treguesit e zhvillimit në tokë bujqësore;
   - për objektet industriale është të paktën 200 m, ndërsa për industrinë e rëndë është të paktën 1000 m;
   - për kullat e telekomunikacionit që janë të larta mbi 25 metra: 30 m nga kufizimi i pronës më i afërt. Këto kulla nuk lejohen të ndërtohen e të vendosen brenda zonave të banimit;
   - për landfill-in sanitar: të paktën 2,500 m;
   - për incinerator-in: të paktën 2,000 m;
   - për impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura: të paktën 1,000 m.
   - distancat për strukturat në funksion të bujqësisë zbatohen sipas legjislacionit të posaçëm.

Neni 64_Normat standardet dhe rregullat për zonat dhe objektet e trashëgimisë kulturore, historike

1. Mbrojtja e Pasurive Kulturore, arkitekturës dhe atyre historike është e nevojshme për të ruajtjen dhe vlerësimin e trashëgimisë historike dhe arkitektonike të Bashkisë Delvinë. Mbrojtja e këtyre Pasurive bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë"

2. Të gjitha ndryshimet apo rinovimet e strukturave të trashëgimisë duhet të bëhen pasi të jetë marrë leja nga strukturat kompetente sipas Ligjit.

3. Strukturat/Njësitë strukturore Monumente përcaktohen në PPV dhe mënyra e ndërhyrjes në to përcaktohet legjislacioni në fuqi.

4. Në rastet kur e lejon PPV dhe legjislacioni në fuqi për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, një ndërtim i ri që bëhet afër me struktura të veçanta Pasurie Kulturore duhet:

- Të theksojë vlerën arkitektonike të strukturës me status "Monument Kulture";
- Të ndërtohet në një distancë të mjaftueshme nga struktura me status "Monument Kulture", që kjo e fundit të mbetet normalisht e perceptueshme;
- Struktura e re mund të jetë në kontakt/i takuar me një strukturë me status "Monument Kulture", vetëm nëse kjo ka një mur kallkan, i cili që në fillim, është menduar të fshihet, mbulohet nga një strukturë ngjitur me të.

5. Lejet zhvillimore, të rikonstruksionit të ndërtesave dhe ato të infrastrukturës në qendrat historike, zonat arkeologjike A, B, duhet të miratohen fillimisht në KKTKM dhe më pas, sipas legjislacionit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

6. Çdo shkëputje e pjesshme ose e plotë e një pasurie kulturore të paluajtshme, si dhe e elementeve në pasuritë kulturore të peizazhit, që përbëjnë pjesë të artit të kopshtit dhe parkut, mund të lejohen në pajtim me dispozitat e ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, pas marrjes së një mendimi pozitiv nga ana e KKTKM-së.

7. Mbikëqyrja e zbatimit të masave të parashikuara në planet për mbrojtjen territoriale dhe të zhvillimit të pasurive të paluajtshme kulturore kryhet nga Inspektorati Kombëtar i Kujdesit për Trashëgiminë Kulturore, në bashkëpunim me autoritetet kompetente qendrore dhe të vetëqeverisjes vendore.

Neni 65_Ndërhyrjet në strukturat e Pasurive Kulturore Materiale

1. Mbrojtja e Pasurive Kulturore materiale bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë".

2. Pasuritë kulturore materiale nuk mund të shkatërrohen, cenohen apo dëmtohen dhe nuk mund të përdoren për qëllime që nuk përputhen me karakterin e tyre historik ose artistik, apo që vënë në rrezik ruajtjen e tyre.

3. Ndalohet kryerja e çdo veprimi që shkakton shkëputjen e afreskeve, stemave, grafiteve, gurëve të varreve, mbishkrimeve dhe elementeve të tjera dekorative të ndërtesave të ekspozuara ose jo ndaj publikut.

4. Çdo ndërhyrje në pasuritë kulturore të paluajtshme dhe të luajtshme kryhet vetëm pas miratimit nga ana e KKTKM-së ose ministrit, sipas rastit të ndërhyrjes në pikën 3, të këtij neni, referuar intensitetit të ndërhyrjeve të parashikuara në kartelën e pasurisë.

5. Mënyrat e trajtimit, normat teknike, kriteret dhe modelet e ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore përcaktohen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në bashkëpunim me institucionet, entet e tjera publike, universitetet dhe institutet e kërkimit të specializuara.

Neni 66_Udhëzues morfologjik për vendbanimet tradicionale dhe rregulla arkitektonike

1. Ndertimet e reja ose zgjerimet nuk duhet te kalojne 20% te volumit te ndertimit ekzistues
2. Tubacionet dhe kabllot duhet te instalohen ne ndertese, ne se jo ato duhet te kene drejtim vertical mbrojtur nga strukture metalike dhe brryla plastik, lyer me ngjyren e nderteses.

3. Tubat e furnizimit me uje, kabllot TV, sateliti, panelet diellor, elementet e airit te kondicionuar duhet te vendosen ne hapesiren poshte catise ose ne nje zone te vecante me vizualitet te ulet.

4. Mbjedhja e pemeve tradicionale lokale, vreshta dhe bime zbukuruese ne kopeshtet/oboret private.

5. Nevojat per parkim duhet te mbulohen se pari ne vendet e parkimeve publike.

6. Muret e jashtme dhe elementët e dyerve dhe dritareve duhet te ruajne vlerat tradicionale te zones dhe te jene sipas arkitektures vernakulare.

7. Kanatet duhet te vendosen ne fasaden e jashtme dhe te lyhen me te njejten ngjyre si dhe dritaret.

8. Parapetet e ballkoneve mund te behen me dru dhe/ose hekur.

Neni 67_Normat standardet dhe rregullat për ndërtimin e varrezave

1. Në kuptimin e kësaj rregullore të gjithë rregullat për ndërtimin e varrëzave në territorin e Bashkisë Delvinë janë konform Vendimit të KM nr. 712, datë 29.10.2014 "Për miratimin e rregullores teknike për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë" dhe Ligjit nr .9220, datë 15/04/2004 "Për shërbimin publik të varrimit" i ndryshuar.

2. Sipërfaqja e pjesës së tokë, e destinuar si fushë varrimi, duhet parashikuar dhe llogaritur mbi bazën e treguesve të përcaktuar në legjislacionin e cituar në pikën 1 të këtij neni.

3. Territori i varrezës duhet të kufizohet nga zonat e banuara, nëpërmjet zonës së rezervuar. Zona e rezervuar përcakton distancën minimale nga kufiri i fushës së varrimit deri tek kufiri i zonës së kategorisë A – Banim përcaktuar në PPV. Zona e rezervuar konsiston në një sipërfaqe të mbjellë me drurë dhe gjelbërime, ku nuk lejohet ndërtimi i objekteve të reja, apo zgjerimi i atyre ekzistuese. Në të mund të parashikohet vetëm ndërtimi i parkimeve, ose i objekteve në shërbim të varrezave. Për qendrat e banuara, me popullsi > 10,000 banorë, zona e rezervuar duhet të jetë jo më e vogël se 100ml, për qendrat e banuara me popullsi < 10,000 banorë, zona e rezervuar duhet të jetë jo më e vogël se 50 ml.

4. Hapësira e varrezave duhet të jetë e rrethuar me mur kufizues, ose rrethim tjetër të përshtatshëm, lartësia e të cilit nuk duhet të jetë më e vogël se 2,5m. Struktura e rrethimit mund të jetë pjesërisht opake, pjesërisht transparente, duke përdorur kangjella metalike me/pa gjelbërim. Perimetri rrethues mund të jetë i realizuar edhe me anë të varrezave murale, për varrosjen e eshtrave, kufomave dhe/ose hirit.

5. Vendet për ndërtimin e varrezave dhe skema funksionale e tyre duhet të përcaktohen duke respektuar të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara në Vendimin e KM nr.712, datë 29.10.2014 "Për miratimin e rregullores teknike për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë".

Neni 68_Përcaktimi i vijës blu, vija mbrojtëse përgjatë elementëve ujorë

1. Mbrojtja e brigjeve është detyrë publike, që realizohet me anë të ndërtimeve, rindërtimeve dhe mirëmbajtjes së pritave, veprave veshëse dhe veprave e masave të tjera teknike, ku përfshihen edhe ato biologjike.

2. Personat fizikë a juridikë, vendas dhe të huaj, pas marrjes së miratimit nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore, mund të kryejnë veprimtari mbrojtëse të përkohshme në raste emergjence.

3. Organet e burimeve ujore mund të përcaktojnë dhe të shpallin zona ose sipërfaqe të mbrojtura sa herë që burimet sipërfaqësore ose nëntokësore rrezikohen seriozisht në sasi e cilësi, si dhe kur ekziston rreziku i përhapjes së sëmundjeve infektive, sipas evidencave nga organet kompetente. Regjimi i këtyre zonave ose sipërfaqeve, si dhe kufizimet e tyre vendosen dhe ndryshojnë sipas rrethanave specifike, të cilat përcaktohen me akt nënligjor.

4. Organet përgjegjëse të planifikimit të territorit në njësitë e qeverisjes vendore lëshojnë leje për ndërtimin, rindërtimin apo shembjen e objekteve mbrojtëse të brigjeve, mureve, pritave e veprave të tjera në brigje, vetëm pasi pajisen me autorizim të posaçëm nga organet e administrimit dhe të menaxhimit të burimeve ujore.

5. Zona mbrojtëse përgjatë elemntëve ujorë përfshin rripat anësorë të tokës përgjatë liqeneve, rezervuarëve dhe shtratit të lumenjve, në funksion të përdorimit të saj, përfshin dy zona:
   - me gjerësi 20 m nga vija e nivelit maksimal prurjes, ku janë të ndaluara të gjithë llojet e ndërtimeve dhe synohet gjelbërimi i zones veçanërisht në zonat subjekt erozioni;
   - me gjerësi 100 m në drejtim normal me tokën nga brinja e sipërme e shtratit natyror, ku janë të ndaluara aktivitete si: nxjerrja e inerteve (veprimtari minerare), hedhja e mbetjeve urbane apo inerte, shkarkimi i ujërave të ndotura të pa trajtuara, si dhe çdo veprimtari e ndaluar nga legjislacioni sektorial.

6. Autoritetet vendore, që hartojnë planet dhe studimet e rregullimit të territorit, marrin në konsideratë planet e menaxhimit të burimeve ujore, të hartuara nga ministria dhe të miratuara nga Këshilli i Ministrave, me propozim të Këshillit Kombëtar të Ujit.

Neni 69_Cilësia dhe përputhshmëria e strukturave

1. Duhet të respektohen standardet e kodit të ndërtimit, rregulloreve kombëtare dhe lokale dhe të kodit profesional.

